

# Kuvendi

## Qarku Korçë

### **Arbjan Mazniku:**

Siç e ndjeni, jemi në takimet konsultative-dëgjuesat me kryetarët e bashkive në lidhje me reformat bisedore territoriale, e cila, siç e ndjeni, kanë nisur prej disa muajsh. Kemi bërë takimet në terren; në Korçë nuk kemi qenë akoma për takimin në terren, i cili do të vijojë, do të jetë në ditët në vijim. Ju falenderoj për kohën dhe prezencën. Modaliteti është që deputetët, edhe si diskutimi që janë bërë, por edhe dëgjuesave, kanë një seri pyetjesh. Do t'ju kërkoja që, së pari, kolegëve që t'i përmbajmë pyetjet thelbësore, duke tentuar të minimizojmë parashtrimet për pyetjet, dhe më pas të presim përgjigjet nga kryetarët. Kur kemi një pyetje që është për një kryetar të caktuar, ju lutem t'ia drejtoni kryetarit për të cilin doni. Nëse është një pyetje për të gjithë kryetarët, ta themi këtë paraprakisht, në mënyrë që më pas secili prej kryetarëve që do dhe mund të përgjigjet, të përgjigjet. Gjithashtu, i kërkojmë kryetarëve që të tentojnë t'i mbajnë pyetjet të përmbledhura ke 2-3 minuta, në mënyrë që t'i japim mundësinë që në kohën që kemi të realizojmë maksimumin e mundshëm të përgjigjeve. Nuk po bëj parashtrime më të gjata, në mënyrë që t'i fillojmë sa më shpejt që të mundur, zoti Boçi.

### **Luçiano Boçi:**

Po, faleminderit për mirëseardhjen. Unë, në fakt, përgjatë kohës që zhvillojmë dëgjuesat këtu në komision dhe në qarqe, kam atë dilemën që është më mirë të dëgjojmë kryetarët e bashkive fillimisht, pastaj të realizojmë dëgjuesën në qark apo anasjelltas, meqenëse kemi dhe zhvendosje. Jo se është koincidenca, por në atë gjykimin tim, nga çka ka rrjedhur deri më tani, gjykoj që është më efektive të dëgjojmë kryetarët e bashkive, duke qenë se janë elementi kryesor i ofrimit të shërbimeve ose elementi bazik në raport me qytetarët, si e konceptojnë ata këtë lloj shërbimi, çfarë pengesash kanë, çfarë duan që të modifikojnë, në mënyrën si e aksesojnë ligjin, çfarë drejte i jep ligji atyre dhe si shihet në fund fare shërbimi që ofrojnë ata ndaj qytetarit. Se qytetari, në dëgjuesat në qark, ka një qasje të ndryshme. Dikush thotë që jam shërbyer mirë, dikush thotë që jam shërbyer keq, dikush thotë që unë jam shumë larg dhe nuk vjen shërbimi ose shërbimi nuk është cilësor. Ka komunitete më pas që insistojnë që të jenë dhe ata përfaqësues në vendimmarrjen, në pushtetin vendor. Tjetër këndvështrim më pas ka ofruesi i shërbimit, që në këtë rast është bashkia, si e gjykon bashkia, sa efektive është puna e saj, përtej dëshirave, sepse asnjëherë s'e kam vënë në dyshim që çdo kryetar bashkie, kur zgjidhet, mbarë detyrimin direkt që ai të jetë shërbyesi më i mirë për qytetarin e vet. Por që të jetë i tillë, nuk mjafton vetëm pasioni dhe dëshira, duhen mekanizmat. Mekanizmat lidhen me funksionalitetin, lidhen me kompetencat, lidhen me mundësitë financiare dhe me të gjithë atë set elementësh që bëjnë që një pushtet vendor të jetë efikas dhe të realizojë qëllimin e tij. Nuk

dua të zgjatem në parashtrime të tjera dhe dua t'ia kaloj menjëherë fjalën deputetëve për të paraqitur pyetjet e tyre. Zotin Nallbati, fjala për ju.

**Bledion Nallbati:**

Faleminderit. Të nderuar kryetar, faleminderit për pjesëmarrjen tuaj në këtë dëgjesë. Unë do të doja të dija nga ju, si kryetar të bashkive dhe si individë që keni kontaktin më të afërt me qytetarin, një opinion në lidhje me reformën e vitit 2014, se cilat kanë qenë sukseset dhe cilat kanë qenë dështimet apo mangësitë e kësaj reforme. Së pari. Së dyti, a jeni ju për një ndarje territoriale si kjo që kemi sot? Për një zvogëlim të numrit të bashkive dhe rritje të territoreve të tyre? Apo për një zmadhim të numrit të bashkive dhe zvogëlim të numrit të territoreve, në mënyrë që të arrijmë objektivin themelor që kemi, që është shërbimi më cilësor dhe në kohë sa më të shkurtër ndaj qytetarëve? Ka një perceptim nga ana e maxhorancës dhe kjo ka qenë edhe një ndër arsyet ose një ndër argumentat e përdorura publikisht përse ne po vijmë në një reformë të re administrativo-territoriale mbas 12 vitesh që bëmë reformën e 2014-s, që bashkitë e vogla janë të paafta për të performuar ekonomikisht dhe të paafta për të realizuar investime. Në këtë mënyrë pretendohet që ta zgjidhim këtë problematikë duke ulur numrin e bashkive, duke zmadhuar territoret. Gjithashtu, në këtë frymë ecet edhe me një pretendim tjetër, i cili është mungesa e kapaciteteve njerëzore në bashkitë e vogla, që për mua nuk qëndron aspak lidhur kjo ngushtë me, po themi, kapacitetet dhe mundësitë që kanë këto bashki për të artuar dhe mbikëqyrur projekte, kryesisht projektet që kanë të bëjnë me Bashkimin Europian. A keni ju, a mendoni që ka mekanizma që e zgjidhin këtë ngërç? Dhe është problem, janë problem kapacitetet njerëzore apo janë problem financat e këtyre bashkive? Financimi i ulët që vjen nga pushteti qendror ndaj pushtetit vendor, kur është bërë reforma administrativo-territoriale, është pretenduar që do të rriteshin, do të rritej decentralizimi i kompetencave, por edhe decentralizimi financiar, pavarësia financiare e njëësive të vetëqeverisjes vendore, ndërkohë që rezulton që nuk jemi. Nuk jemi në pritshmëritë që kishte kjo reformë. Nga ana tjetër, po ashtu nuk kemi arritur as objektivat e tjera që kishte vendosur qeveria në atë kohë, që me këtë reformë do të ulte ndjeshëm shpenzimet për punonjësit në pushtetin vendor, si kundër pretendohet që do të ulej edhe numri i punonjësve në administratën vendore. Në fakt, rezulton që ka ndodhur e kundërta. Si e shikoni ju këtë situatë? Faleminderit.

**Sotiraq Filo:**

Faleminderit. Në rast se mund të përgjigjem unë, po filloj unë.

**Arbjan Mazniku:**

Filloni ju dhe pastaj secili prej kryetarëve të tjerë që kanë një pikë.

**Sotiraq Filo:**

Po. Fillimisht, faleminderit për ftesën edhe për mundësinë për të diskutuar me Komisionin e Reformës Administrative dhe Territoriale, në këtë moment që unë gjykoj është i rëndësishëm dhe që i paraprin reformës së re. Tani, po e fillojmë me pyetjen e parë. Pra,

cili ishte efekti i reformës të vitit 2014, e cila i filloi efektet e saj në vitin 2015? Sot jemi 11 vjet pas kësaj reforme dhe besoj është një periudhë kohore e mjaftueshme për të dhënë disa gjykime dhe disa konkluzione. Tani, po e them me një fjalë që në fillim, që padyshim që reforma e vitit 2014 ishte një reformë e suksesshme. Në të gjitha ato që ishin pritshmëritë apo synimet që qëndronin pas kësaj reforme, që lidheshin me eficientë në mbledhjen e të ardhurave dhe në kryerjen e shpenzimeve nga ana e bashkive të mëdha, përta i takon sinergjisë të burimeve, pra një nga qëllimet e reformës ishte sinergjia e burimeve, për shembull, në një sektor të caktuar, siç mund të ishte sektori i turizmit, bashkia e vjetër që administronte vetëm qytetin e Korçës kishte një grup të caktuar të atraksioneve apo të potencialit të saj turistik, ndërkohë që e kombinuar edhe me territorin që iu bashkua me fshatrat turistike të Dardhës, Voskopojës, Vitkuqit dhe me resurse të tjera natyrore, patjetër që u krijua një sinergji më e madhe dhe e plotësoi atë ofertën turistike të bashkisë së madhe, duke dhënë një kontribut më të ndjeshëm në impaktin ekonomik që kishte ky sektor tek ekonomia lokale. Pra, e para, eficientë në mbledhjen e të ardhurave dhe në kryerjen e shpenzimeve; e dyta, sinergji në burimet ekonomike; e treta, patjetër, mundësi më e madhe aksesit tek kapacitete njerëzore dhe, padyshim, si rrjedhojë edhe eficientë më të madhe në mbledhjen e të ardhurave dhe në kryerjen e shpenzimeve, për shkak të asaj që është edhe parim ekonomik të ekonomisë të shkallës, bashkitë e mëdha kishin mundësi jo vetëm teorike, por dhe praktike të kryenit më tepër investime dhe me një këndvështrim më strategjik, duke parë një territor më të madh dhe duke e parë në një këndvështrim, siç thashë, më strategjik. Unë mund të jap edhe disa shifra konkrete, për shembull, në drejtim të mbledhjes së të ardhurave, ne kemi gjetur, po flas për njësitë administrative, para 2015-s, mbledheshin 19.5 milionë lekë, ndërkohë sot mbledhen 98.3 milionë lekë. Pra, ka një rritje me katërfish të të ardhurave që mbledhen. Përta i takon investimeve, mund t'ju jap vetëm një shembull që është shumë signifikativ: ndriçimi publik. Kemi gjetur njësi administrative me fshatra ku ishin vendosur vetëm 700 ndriçues dhe fshati më i madh i njësisive administrative që iu bashkuan Korçës, që ishte fshati i Bulgarecit, kishte vetëm 6 ndriçues, ndërkohë që sot kemi vendosur mbi 3000 ndriçues. Po marr një shembull që nuk është shumë i rëndësishëm në drejtim të vlerës së investimit, por tregon atë ndryshimin e madh që ka ndodhur me ofrimin e këtij shërbimi që përkthehet në cilësi më të mirë jetese për banorët dhe shembuj të tillë mund t'i jap në të gjithë drejtimet e tjera. Përta i takon periudhës kohore, administrimi i pushtetit vendor pas viteve '90 ka filluar në vitin '92 dhe '92 deri sot është një periudhë prej 34 vitesh. Këto 34 vite janë ndarë në dy të tretat, pra 23 vite administrim me bashki dhe komuna dhe 12 vite ose 11 vite, ose një e treta në administrim me bashki të mëdha. Dhe ju siguroj dhe mund të pyesni në çdo fshat të bashkisë së madhe të Korçës që punët që janë bërë gjatë këtyre 11 viteve, pra në një të tretën e periudhës kohore, kanë qenë shumëfish i punëve që kanë mundur të bëhen gjatë dy të tretave të kohës që i ka paraprirë reformës dhe kjo është e kuptueshme për të gjithë arsyet që unë përmenda më sipër, pra efektet që reforma ka patur. Dhe në rast se mund t'i bëj një pyetje edhe pak, edhe konstatim me shumë dashamirësi zotit Albati, ai fatmirësisht mund të japë një qasje edhe një opinion edhe personal në lidhje me efektet e reformës të vitit 2014, sepse ka qenë edhe vetë kryetar bashkie i një bashkie të madhe. PD-ja, Partia Demokratike, edhe në 2014 e kontestoi reformën, nuk mori pjesë, por jam shumë i sigurt që më vonë me siguri u bë pishman në

thonjëza për këtë gjë dhe deputetin Albati po ta pyes sot, mbase jo këtu në komision, po mënjanë në kafe, miqësisht, që do kishte preferuar dhe puna jote si kryetar bashkie do kishte më tepër efekt po të drejtoje vetëm bashkinë e Bilishtit apo po të drejtoje siç ke drejtuar bashkinë e madhe të Devollit, jam shumë i sigurt.

**Luçiano Boçi:**

Zoti Filo, të lutem, të lutem.

**Xhelal Mziu:**

Ka ndodhur 5 llamba nëpër komuna.

**Luçiano Boçi:**

Po pra, tani zoti Filo, për çfarë pyetje?

**Luçiano Boçi:**

Zoti Filo, më fal, më fal, ja një minutë se jam po ndërhyj si drejtues i komisionit. Tani, ajo që kërkojmë, ajo që kërkojmë ne dhe që kemi kërkuar dhe nga kryetarët e tjerë të bashkive, së pari është të flasin numrin një për bashkinë e tyre, së pari, jo për të gjitha bashkitë, se nuk përfaqëson të gjitha bashkitë. Së dyti, nuk kërkojmë parashtrim dhe konsiderata si e gjykon ti kohën para 2014-s, pra si e gjykon 2005-ën, por jemi këtu për të thënë që 2014-ta ndërtoi pritshmëri dhe objektiva të cilat ku janë sot janë realizuar dhe si janë realizuar. Ky është konteksti dhe ajo që është më kryesore dhe më kryesore është që kryetarët e bashkive në komision, në seancë dëgjimore, i japin përgjigje pyetjeve që shtrihen nga deputeti. Në qoftë se hyjmë në insinuata, në përsijatje, në krahasime kohore, nuk mbaron debati asnjëherë, sepse unë jam dakord me këtë që tha Xhelali pa mikrofon. Nuk mund të themi këtu ne u shtuam për 10 vite 3000 drita apo 4000 drita dhe u krye gjithçka nga qëllimet që kishte reforma. Pra, për ato pyetje që ka bërë zotin Albati, duhet të qëndrojmë korrekt. Hapet debati dhe nuk mbaron asnjëherë.

**Sotiraq Filo:**

Dakord. Edhe një ndërhyrje ngaqë një moment. Të lutem, të lutem, unë e thashë vetë që e kisha fare pa të keq atë konstatimin dhe nuk e di pse duhet të ishte ai lloj reagimi nga ana e deputetit Mziu. E kisha fare pa të keq dhe mirë, dakord, dakord. Atëherë po bëjmë, më fal, dakord, gabim për paralelen Qoqa. Unë mora vetëm një shembull që më duket e demonstroi ndryshimin, por në rast se duhet të flasim për shifra më konkrete, po atëherë gjatë këtyre 11 viteve janë investuar në njësi të administrative 3.3 miliardë lekë. 30.

**Xhelal Mziu:**

Po pritet, po pritet me përqindje dhe me tendenca, do të themi 3 miliardë.

**Sotiraq Filo:**

Po me përqindjet kujt tani? Xhelal, Xhelal, më fal tani, o Xhelal, të lutem.

**Xhelal Mziu:**

Kemi parë 3 milionë, kemi shkuar 7 milionë.

**Sotiraq Filo:**

Më fal tani, në rast se na keni thirrur të na dëgjoni, na dëgjoni, unë s'. Po mirë, pra tani.

**Bledion Nallbati::**

Ai, o zoti Mziu, ore një moment. Ju lutem, më dakord. I kemi ftuar njerëzit për pyetje.

**Bledion Nallbati::**

Po pra, okej, meqënëse more, po bëj një sqarim të vogël. Shiko, ne e bëjmë edhe atë diskutim, edhe atë debat, mbasi të mbarojmë këtë serinë e pyetjeve të kolegëve, se nuk kam vetëm unë pyetje, kanë të gjithë përsa i përket reformës. Ne si anëtarë të opozitës e kemi deklaruar që në fillim, që në krye të herës, që ne kemi qenë dakord që Shqipëria ka pasur nevojë për një reformë administrative territoriale. Si kundër, kemi thënë dhe vazhdojmë të themi që ajo reformë, edhe për shkakun se u bë në mënyrë të njëanshme, pa pasur një konsensus nga palët e tjera politike, dhe kur bën një reformë të tillë, nuk mund ta përvetësosh. Dhe kemi pretenduar dhe pretendojmë që ka një sërë problematikash. Pyetja ime ndaj jush, të gjithë kryetarëve të bashkive, nuk ishte personale dhe as për në mënyrë individuale për ju, por ishte, unë thashë, cilat janë sukseset dhe dështimet apo mangësitë? Deri tani ke thënë që ka pasur suksese. Mund të thuash që ka qenë, nuk ka asnjë mangësi dhe këtu nuk ka asnjë problem. Kjo është e drejta jotja. Ne këtu pyesim që të kuptojmë më qartë nga ju ku çaloi kjo reformë, në mënyrë që të adresohen në reformën tjetër. Por nëse ju mendoni që kjo reformë ka qenë perfekte, atëherë s'ka problem. Mund të thoni këtë: ka qenë perfekte dhe kaq. Por nëse do ishte perfekte, duhet të kemi parasysh një gjë: nëse do ishte perfekte, nuk do të ishim sot këtu për një reformë të re, apo jo?

**Sotiraq Filo:**

Tani, më vjen mirë që ne bashkë u mirëkuptuam, sepse pyetja ime ishte pa tendencë. Ishte, dakord, pra nuk pate, nuk e kuptova, me thënë të drejtën, ish-kolegun për atë lloj ndërhyrje, se e kisha fare pa të keqe. Dhe tani, në rast se na pyesni, okej, pra tani, se ne kemi ardhur të përgjigjemi, për këtë kemi marrë rrugën. Për mua, reforma ishte e suksesshme dhe ishte nevojë, ishte domosdoshmëri, jo nevojë, por ishte domosdoshmëri që duhet të kryhej dhe objektivat e asaj reforme u arritën. Patjetër që mund të ketë patur edhe problematika të caktuara. Reforma në vetvete jo. Pastaj, pjesa e decentralizimit që ndoqi këtë reformë, pra në vitin 2016 u bë dhe reforma e decentralizimit të kompetencave, një pjesë e kompetencave që i kishte patur pushteti qendror, i mori pushteti vendor. Atje, në rast se mund të bëj një konstatim, është që po, ka nevojë për mbështetje më të madhe financiare për bashkitë. Në rast se bashkitë do mbulojnë një territor më të madh, shoqëruar edhe me kompetenca më të mëdha, këto duhet të shoqërohen me një mbështetje adekuate, të përshtatshme financiare, që ne të kemi mundësi t'i kryejmë këto

kompetenca ashtu si kundër duam edhe ashtu si kundër presin edhe banorët, edhe komunitetet nga ana jonë. Kjo është ai një konstatim që unë mund ta bëja në raport me pjesën e shërbimeve që ofron bashkia e Korçës. Nuk dua ta zgjas se mora dhe më tepër kohë në këtë pyetje të parë. U zgjatëm pa dashur. Mbase dhe kolegët kanë diçka.

**Arbjan Mazniku:**

Po, do doja të dëgjonim dhe kolegët e tjerë. Në fakt, është e vërteta. Zoti Topçiu.

**Gëzim Topçiu:**

Përshëndetje të gjithëve. Unë dua ta përmbledh këtë si pyetje, si konstatim, që reforma e 2013-së ishte e domosdoshme për një dhe po të marrim numrin e komunave që kanë qenë me numrin e bashkive që reforma solli mbas 2014-s, të gjithë jemi të bindur që duhesh bërë kjo reformë. Sa ishte rezultate kjo, pastaj lë për t'u parë rast pas rasti, bashki pas bashkie, dhe unë mendoj që ky si moment duhet parë si ka qenë ecuria e çdo bashkie. Dhe unë mendoj, po marr rastin e bashkisë së Maliqit, që bashkia jonë ka një rritje të financave vendore, ka shtuar investimet në territor dhe ka mbajtur në nivele të kënaqshme shërbimet ndaj komunitetit. Si i ka mbajtur? Se kështu duhet parë. Po s'u panë të paktën tre kolonat kryesore: të ardhura, shpenzime, të kthyerat, investime dhe shërbimi ndaj komunitetit, atëherë nuk kemi çfarë të diskutojmë për reformën. Diskutimi për shërbimet ndaj komunitetit për mua është bazë, dhe nga ajo që unë dua të bëj me dije komisionit është që ne kemi ruajtur pothuajse në çdo njësi administrative shërbimet bazë që kanë të bëjnë me ish-komunat, të cilat qytetarët të mos lëvizin edhe të mos ecin kilometra të tëra për të marrë një shërbim. Dhe kjo është e verifikueshme për nivelin e shërbimeve që ne kryejmë në shërbimet sociale, për bujqësinë, për konfliktet, për të gjithë shërbimet e mundshme apo funksionet që pushteti lokal zbaton. Për investimet, as bëhet fjalë që niveli i investimeve në bashkitë me organizimin e ri ka patur një rritje të konsiderueshme, dhe unë mund të them në të gjitha, po thua në të gjitha njësitë administrative, ne kemi realizuar në çdo fshat katër-pesë rrugë asfaltime për çdo fshat që nuk ishin parë nga ish-komunat. Edhe për mungesë fondesh, edhe vizioni ka ndryshuar, dhe ecuria patjetër e taksave, e investimeve ka ndryshuar në të përgjithshmen, edhe si transferte e buxhetit qendror, por dhe e grumbullimit të të ardhurave që bashkitë realizonin nga njëri vit në tjetrin, dhe kjo është e verifikueshme nga të gjithë ata të cilët duan ta bëjnë një verifikim nga 2014-ta edhe deri në vitin 2026. Në lidhje me momentin e dytë që deputeti parashtrroi, a jeni për një ndarje të re apo ju mendoni që duhet të eci me zmadhim apo zvogëlim? Unë mendoj që reforma nuk duhet parë si zmadhim apo zvogëlim ndarje territoriale. Për ne si drejtues të pushtetit lokal, duhet parë si kompetenca dhe mbulim financiar i funksioneve dhe kompetencave që ka pushteti vendor. Për mua, pak e rëndësishme është cila do jetë madhësia e bashkisë. E rëndësishme është që një funksion që i jepet bashkisë mbulohet financiarisht, ndiqet, pasi edhe këtu reforma e vitit 2014 ka momente që duhen diskutuar. Ne kemi disa funksione të cilat minimalisht nuk i mbulojmë siç ne që drejtojmë bashkitë do ishim të kënaqur për të rënë. Mund të jenë rrugët rurale, pyjet dhe kullotat, apo disa funksione të tjera që kanë dhe një ndërthurje me pushtetin qendror, siç mund të jetë ujitja, kullimi, për të cilat kanalet e para i ka ndërmarrja rajonale.

Ne kemi kanalet e dyta, dhe problematikat pastaj sjellin atë gjendje që ne hasim dhe vështirësi për zbatimin dhe për mbështetjen e të gjithë shërbimeve që kanë të bëjnë me komunitetin. Në lidhje me bashkitë e vogla, po shkoj tek momenti i fundit, të afta, të paafta, unë do e shikoja që nuk është se duhet të flasim bashki të afta, të paafta. Nuk do ta përdoria këtë si nocion. A ka urdhëro? Nuk e di. Unë po flas në konceptin tim. Dua të them që burimet njerëzore kanë një përmirësim me ndryshimin e fondit të pagave, e nivelit të pagave, por ende bashki që janë në periferi apo që s'kanë mundësi për inxhinier, arkitekt, mund ta ndejnë këtë vështirësi, dhe këto pastaj sjellin edhe një shërbim më të dobët se bashkitë e mëdha, për të cilat është në një nivel më të lartë, dhe ndoshta shërbimi kryhet në një kohë më të shpejtë. Kaq kisha mbajtur shënim. Kështu që po të shpresojmë që kam qenë konç.

### **Luçiano Boçi:**

Po, atëherë një ndërhyrje të përsëritur që më vjen keq që e përsëris, se kur jemi dëgjesa publike, me publikun është shumë e vështirë, por me kryetarët e bashkive mendoja që do ishte shumë e lehtë. Dhe njëherë, krahasimi është me pritshmëritë dhe objektivat që përcaktoi 2014-ta. Mos ta bëni si dikur, në krahasim me vitin 1938, Shqipëria socialiste kishte ecur shumë përpara. Mos ta bëni të tilla formula, sepse këtu jemi. Zbëras një krahasim me të. Krahasim me të dikurshmen për 2005-ën, që janë bërë rrugë që nuk do bëheshin më përpara, duhet të keni të dhëna të sakta, sepse nga të dhënat zyrtare, Partia Demokratike në kohën e saj, mandati tetëvjeçar, ka bërë rrugë në fshatra 18 mijë kilometra. Po tani, një minutë. Po mirë, pra dakord, shumë mirë që ka qenë që në 2003-shin. Unë po jap date dhe një herë tjetër.

### **Gëzim Topçiu:**

Në qoftë se komisioni e kërkon, e japim këtë evidencë, por nuk është.

### **Luçiano Boçi:**

Ja një minutë, që të jemi shumë të saktë, edhe një herë, që të jemi shumë të saktë, shumë mirë që ka qenë që në 2003-shin dhe shumë mirë që është edhe tani, por duhet të bëj këtë krahasim me pritshmëritë dhe objektivat. Dhe shumë mirë, sepse e dëgjova, domethënë, në mënyrë realiste të thoshte pjesën e dytë, që se kam thënë, se kam thënë atë pjesën, pjesën reale, domethënë, që disa funksione nuk i realizon dot, sepse është e vërtetë, mungojnë kompetencat. U tha në mënyrë, domethënë, trumbullakosur, por është shumë e vërtetë. Deri aty mund të atakoni, normal, se është përgjegjësia e qeverisjes dhe nuk ka shoqërim me një set financiar që ti të realizosh kompetencën. Dhe këtu jam okej, por në këto krahasimet, në 10 vite, 1/3-ta u bë trefishi, dyfishi, nuk janë shifrat e sakta këto, sepse tek e fundit pyetja sfiduese është: po sa vite e ka pasur e majta Korçën? Ju, domethënë, po bëni krahasim me veten tuaj, sepse është përgjegjësia juaj, apo jo? Jo, po nuk. Jo, jo, nuk e kam me ty. E kisha, në fakt, më shumë me zotin Filo, se thashë Korçën. Nuk. Jo, dakord, dakord. Pra, zoti Filo, nuk e kam për replikë, por nuk e kam fare për replikë. Pra, dhe njëherë, zoti Filo, që të jemi të qartë, për të gjithë kryetarët, nuk e kam me ju specifikisht apo me zotin Topçiu. Me pritshmëritë, pra, jemi 2014 dhe si ka vijuar.

Po pra, atë pyetjen për 2014-ën, kjo që mbani sukses. A mundem? Po pra, çfarë funksionoi për 10 vite? Çfarë funksionoi nga pritshmëritë, nga objektivat? Çfarë ka funksionuar dhe çfarë nuk ka funksionuar? Shumë e qartë më është pyetja.

### **Arbjan Mazniku:**

Miq të nderuar, se jemi, jemi, jemi të gjithë njerëz. Jemi të gjithë njerëz të cilët kanë marrë votën e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë. Jemi të gjithë adultë të vaksinuar dhe dimë të gjithë. Flasim gjuhë letrare shqip. Është bërë një pyetje në gjuhën shqipe, shumë e qartë, dhe do marrin një përgjigje nga njerëzit të cilët udhëheqin qytete. Dinë, nuk ka nevojë t'i bëjmë neve as përkthimin shqip-shqip të pyetjes, as të bëjmë përkthimin shqip-shqip të përgjigjes. Pra, njerëzit janë këtu, kanë dëgjuar pyetjen, t'i japin përgjigjen. Mos ti, domethënë, kjo diskutimi që... Po, në, në, më fal, se shoh të arsyeshme këtë që janë procedura. Pastaj do të them vetëm procedura. Unë tani do të na lë.

### **Luçiano Boçi:**

Mbaron një minutë, zoti Filo, një minutë, se meqënëse jemi shqip dhe po flasim shqip, edhe meqënëse unë ironinë e pëlqej shumë, edhe u përdor kjo e ironisë shqip, edhe u përmend dhe jemi të gjithë vaksinuar. Ëh, ndonjëri? Jo, jo, mund të ketë marrë. Varet nga lloji i vaksinës që ke marrë, zoti Mazniku. Domethënë, ti e ke vaksinën politike të fortë. Ne s'e kemi aq të fortë, kështu që ç'të themi ne? Kështu që kjo... Po, pra, shiko, s'jemi këtu para, domethënë, kështu që mund të vazhdoni, zoti Filo.

### **Sotiraq Filo:**

Ne na gjetët që të bëni këtë debatin midis jush, po të mbarojmë.

### **Klevis Jahaj:**

Shko, më fal, një, një diçka. Tani, se realisht është edhe besoj edhe kryetarët kanë lënë dhe punët e tyre. Tani mund të vendosim një rregull për të gjithë anëtarët e komisionit që nuk ka komente mbi pyetjet. Nuk besoj që as nga kryetarët, as nga ne ka bërë ndonjë komente për pyetjet që janë drejtuar nga opozita, pavarësisht se kanë qenë objekt i reformës ose jo, i sepse jemi mbledhur. E dyta, e dyta, nuk besoj kryetarë dhe bashkëkryetarë që ka një përgjigje të keqe. Ata janë persona të zgjedhur, kanë të gjithë përgjegjësinë për të folur dhe për t'u përgjigjur për pyetjet e tyre. Në qoftë se ka ndonjë gjë që nuk i pëlqen, është tjetër diskutim. As ata nuk komentuan pyetjet, nuk i përgjigjem unë pyetjet deputetit se s'më pëlqen, ndërkohë që ju komentoni, s'më përgjigjeni mua, s'më pëlqejnë përgjigjet e pyetjeve. Duhet të vendosim një rregull për këtë. Kjo është një konsum i kohës së të gjithëve dhe nuk e ndihmon as debatin, as qëllimin që jemi mbledhur këtu, dhe është në respekt të të gjithëve. Nuk besoj që ne jemi të gjithë të zgjedhur këtu. Kush nis mbyllur, kush nis të hapur, se s'po i vendos njeri këto. Po aman të respektojmë njëri-tjetrin dhe komentojmë për njerëz që kanë, për njerëz që kanë që në dymbëdhjetë vite që kanë në atë detyrë dhe këtu komentojnë që nuk duam atë. Kështu që mendoj që është më mirë, që është më mirë po le më tani se s'më bën mua komente ti në lidhje me këtë. Është më mirë që të kemi respekt për këtë përgjigje.

**Bledion Nallbati:**

Faleminderit shumë që na sqarove. Unë besoj që ju drejtova me shumë respekt gjithsecilit prej tyre, për më tepër që janë kryetarë të bashkive të qarkut tim dhe njohjet i kam edhe personale me gjithsecilin. Kështu që nuk besoj që kanë nevojë për avokaturën e askujt. Madomendja janë të zotë të përgjigjen. Unë kisha tre pyetje të qarta të cilat mund të marrin një përgjigje të kthjellët pa bërë shumë, se po të hyjmë pastaj për diskutime. Gjithsecili prej nesh e mban fjalën nga një orë e gjysmë edhe mund të thotë, mund të flasë për ato fitorjet mbas fitorjeve. Unë desha të di si kryetar bashkish, si njerëz me përvojë në këtë, në këtë drejtim dhe si njerëzit që kanë kontaktin më të afërt me qytetarin dhe vijnë këtu për të sjellë edhe një opinion të qytetarëve të tyre. Faleminderit. Pa diskutim që pres jam. Ja ta mbaroj. Duket se po e mbarova. Pa diskutim që nuk pres të thonë që reforma ishte e dështuar, por unë kërkova thjesht qartë cilat janë sukseset dhe cilat janë, s'thashë dështimet, se do t'u dukej shumë rëndë, por cilat janë defektet që ka kjo dhe ende nuk po marr një përgjigje të qartë. As duhet të ketë. Po a pse duhet të vijnë pastaj. O, o, Klevis! Domethënë, e mbyllim. Po pse duhet të vijnë? Po qenëse këtu kanë erdhur për të na parë ne, pastaj është histori tjetër kjo, nuk besoj që i ka marrë malli të na shikojë ne.

**Arbjan Mazniku:**

Z. Nallbati, ë, i bëtë pyetjet? Ishin të qarta? T'i japim kohë të përgjigjem kryetarët. Janë përgjigjur zoti Filo dhe zoti Topçiu. Nëse mund të dëgjojmë, po, zoti Filo, çfarë është shtuar?

**Sotiraq Filo:**

Vetëm, vetëm një diçka, sepse u insistua disa herë nga ana e bashkëkryetarit të komisionit, zoti Boci, ë, cilat ishin realizimet e reformës në raport me objektivat. Tani, ë, reforma në vitin 2015 nuk është se ka patur objektiva të specifikuar sasiore, në sensin ka qenë më tepër mbledhje të ardhurash, ka qenë më tepër investime, ka qenë në, ë, kuadri i përgjithshëm që bashkimet e mëdha kanë mundësi të bëjnë përdorim më eficient të mbledhin më tepër të ardhura, të bëjnë përdorim më eficient të tyre, të bëjnë sinergji të burimeve, të kenë akses në kapacitete njerëzore, të bëjnë më tepër investime. Nuk është se ka qenë edhe të më pyesësh tani, ore, ke thënë që do bëhen 1 miliard lekë investime, sa ke bërë? Nuk ka pasur terma të tillë.

**Bledion Nallbati:**

Jo, jo, jo, nuk është, nuk është kështu. Nuk është kështu. Ë, ka pasur pa diskutim edhe, edhe terma konkretë, ë, në sensin të cilat janë propaganduar më të madhe. Do të ulet numri i punonjësve, do të ulen shpenzimet, do të ulen shpenzimet. Po, ë, me 80 milionë dollarë pretendoi atëherë dhe kanë ndodhur e kundërta. Kjo nuk ka qenë vetëm me Korçën, ka qenë e përgjithshme, por kanë qenë, kanë qenë dhe ne, ne e dimë mirë këtë punë. Kemi qenë në bashkëvuajtës të eksperimentit të asaj kohe.

**Sotiraq Filo:**

Nuk është, nuk është se ka patur indikator sasior për çdo

**Bledion Nallbati:**

Të përcaktuar mirë. Madje do të kemi kursim 80 milionë dollarë, ulje të shpenzimeve,

**Arbjan Mazniku:**

Se ishim shumë mirë. Ishim shumë mirë. Bëtë pyetjet tani. Pse e bëj pyetjet?

**Bledion Nallbati:**

Ka pasur një objektiv të qartë të qeverisë atëherë që do të ulej me 80 milionë dollarë, do të kurseshin 80 milionë dollarë.

**Arbjan Mazniku:**

Ju lutem, me shumë respekt,

**Bledion Nallbati:**

Shpenzimet për pagat e punonjësve, për pagat e sigurimit të punonjësve.

**Arbjan Mazniku:**

Ne, secili prej nesh, secili prej nesh në vijimësi do ketë drejtën e konkluzioneve të vetë, por nuk kemi drejtë mbi opinionin e atij tjetrit. Çdo njeri ka opinionin, mendimin e vet dhe thotë siç e thotë ai dhe mos shkoni të tentoni të ndikoni ndeshje, ta thotë atë që dua unë. Ta thotë si mendon. Pastaj do bëjmë debat. Bazohemi këtu dhe bëjmë debat. Po s'është ashtu. Po s'ka problem. Po e bëjmë debat. Po s'është për ashtu se kam unë informacion për atë sa doni ju. S'është ashtu. Ë, zoti Dura.

**Eduardo Duro:**

Atëherë, përshëndetje të gjithëve dhe faleminderit për ftesën. Atëherë, do t'i përgjigjem shumë shkurt dy pyetjeve për reformën e 2015-ës. Ë, unë besoj se bashkia nuk është thjesht një institucion, por është një vend ku komuniteti i asaj bashkie, apo i atij territori, njih veten dhe njëson veten me atë bashki. Dhe unë besoj që reforma e 2015-ës, të paktën për bashkinë Devollë, ka qenë efektive, kurse në anën tjetër pozitive është rritja e efikasitetit të administratës së bashkisë Devollë. Bashkia Devollë ka krijuar një administratë funksionale në shërbim të komunitetit dhe rritje të shërbimeve ndaj banorëve të kësaj bashkie. Efikasiteti në mbledhjen e të ardhurave, unë nuk do bëj krahasimin me vitet e tjera, por do bëj krahasimin me vitin 2016. Është dyfish e gjysmë sot gjelja e të ardhurave, se është rritur vlera e të ardhurave të përbashkitë Devollë nga të ardhurat e veta dhe normal që do rritet dhe vlera e investimeve për komunitetin.

**Pali Kolefski:**

Përshëndetje të gjithëve. Faleminderit për ftesën. Bashkia Pusthec, siç e dini, është bashki minoritare. Edhe reforma e 2016-ës që u bë, domethënë, ka lënë këtë bashki më vete për efektin e minoritetit maqedon, as i cili tonte këtu në këto territore. Ndryshim të sipërfaqes së vet ose të territorit nuk ka patur. Ka qenë ish-komuna Liqenas, pastaj u bë bashkia Liqenas dhe më vonë u ndryshua bashkia e Pusthecit. Unë mendoj, edhe këtë e kam ndjekur, edhe them, mendoj që reforma ka patur shumë gjëra pozitive, sepse unë po shikoj që bashkia, në krahasim, duke krahasuar me komunën, thjesht edhe me, me, me, me punët dhe me të gjitha, bashkia ka performuar dhe performon shumë herë më mirë në krahasim atëherë kur kishte kompetenca të kufizuara. Tashi, a ka nevojë për përmirësim? Do t'i përgjigjem edhe kësaj pyetjeje. Mendoj që po. Mendoj që po, edhe duhet parë. Kjo është me shumë seriozitet, sepse në ato raste, për shembull, kur po flasim që ka nevojë për përmirësim, duhet parë, duhet parë disa marrëdhënie midis institucioneve qendrore dhe pushtetit lokal. Në rastin konkret, ne ndodhemi 100% në një zonë të mbrojtur. Ku për shkak të kësaj, bashkia në këtë, në këtë, në këtë fushë mund të themi që çëdon, sepse këtu nuk janë të përcaktuara qartë kompetencat e secilës palë. Domethënë, ne jemi bashki ku s'kemi të drejtë të ushtrojmë funksionet tona në territorin tonë për sa i përket zonës së mbrojtur. Për pjesën tjetër, për mbledhjen e taksave, për performimin patjetër që këtu ka një përmirësim shumë, shumë të dukshëm, bile, sepse më përpara mund të themi që nuk bënte një procedurë fare të thjeshtë ish-komuna ose bashkia, sepse territori nuk ka ndryshuar. Kurse tashi, qoftë edhe me ndryshimet e fundit për pagat që keni qenë edhe ju vetë, zoti Mazniku, këtu ka, unë po shikoj një përmirësim të dukshëm në bashki. Kaq kisha.

#### **Arbjan Mazniku:**

Leski, nga bashkia Kolonjë, nuk kemi kryetarin. Kemi nënkryetarin. Doni t'i përgjigjeni kësaj pyetjeje? E bëmë dhe diskutimin paraprakisht. S'po e ribëjmë që në fakt kryetarëve do t'u japim një mundësi që të kthehen, sepse donim që të ishin kryetarët sipërfaqësues. Po, meqenëse jeni këtu.

#### **Bashkia Kolonjë:**

Përshëndetje të gjithëve. Kënaqësi për faktin që kemi mundësinë të delegoj fjalën si pjesë e drejtuese e kabinetit për bashkinë Kolonjë, nënkryetar ndërkohë Ristana Gjergo. Ë, krahasuar me reformën, pra se si ka qenë gjendja e bashkisë Kolonjë para reformës së vitit 2014, tani unë do bëj diferencën se unë asako e kam qenë thjesht një banore e bashkisë Ersek, e cila tashmë ka bërë një, pas kësaj reformës të 2014, ka bërë bashkimin me bashkinë Ersek dhe Leskovik në emërtimin bashkinë Kolonjë. Megjithëse unë nuk jam banore e Leskovikut, jam banore e bashkisë Ersekë, më duhet të nënvizoj se investimet më të mëdha janë bërë pikërisht në bashkinë Leskovik gjatë periudhës që ka qenë pjesë e kësaj, e këtij emërtimi për bashkinë Kolonjë. Çfarë do të thotë kjo? Ka të bëjë pikërisht me vëmendjen e shtuar që morën hapësirat, qoftë komunat, qoftë bashkia e vogël që ka qenë Leskovik, pikërisht pas reformës territoriale të këtij viti. Ë, nga ana tjetër, rritja e shërbimeve, ngritja e numrit, e nivelit të numrit të bizneseve, kryesisht atyre agro, agroturizëm, kryesisht, mendoj se është një tregues shumë eficient ose efektiv për faktin

se kthimi i të rinjve kolonjarë për të investuar në këtë hapësirë pas reformës territoriale nënkupton vëmendjen e shtuar për biznes, për të bërë, për këtë, për ta shfrytëzuar këtë hapësirë për biznes dhe jo më pak për të rritur dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimit të jetës të këtij komuniteti. Ë, nga ana tjetër, mendoj se detaji që mund të jetë më i nënvizuar për bashkitë e vogla, përfshirë këtu dhe bashkinë Kolonjë, se si menaxhohen apo, ë, se si menaxhohen, po themi, këtu hapësirat si ose shërbimet si njëësia e sektorit, sektori më saktë i projekteve të huaja apo mungesa e individëve që janë specialistë të fushave të caktuara, kjo është një sfidë e bashkive të vogla, padyshim. Por nga ana tjetër, mund të them se në rastin konkret, bashkia Kolonjë ka ditur ta menaxhojë më së miri dhe vonesa e vetme që mund të ndodhë është vetëm në pikëpamjen kohë, por jo në efikasitet. Faleminderit.

### **Bledion Nallbati:**

Atëherë, kam të drejtë në një koment, besoj, për të gjithë. U përpoqa të isha konkret në pyetje. Mora vetëm përgjigjen që reforma ka qenë e suksesshme. Nuk mora asnjë përgjigje në lidhje me problematikat që ka pasur. Unë jam i sigurt që ka problematika. I kam përjetuar edhe vetë si ish-kryetar bashkie. Kemi ndarë të njëjtat halle edhe me një pjesë të kolegëve që janë, vazhdojnë të jenë sot kryetarë bashkish. E kuptoj edhe mungurimin që keni për t'i përmendur. Ë, dhe po them, ë, Raqi përmendi ndjesë që po të referohem me emër. Përmendi vetëm një problematikë për sa i përket bashkisë së Korçës që tha: "Mund do ishte mirë të kishim ca para më shumë, ca financa më shumë në raport me kompetencat të cilat nuk janë mbështetur ashtu si duhet." Është e vërtetë që një pjesë e mirë e kompetencave nuk janë financuar si duhet, për të mos thënë që janë financuar në mënyrë qesharake, së paku në atë kohë kur ne filluam bashkarisht këtë punë, duke e nisur nga, po them, emergjencat civile. Ë, nuk e di, po besoj Korça mund të ketë qenë diçka më ndryshe, po Maliqi dhe Devolli e Pustecin atë kohë kanë qenë në ditalit me ca mjete që i përkisnin kohës së Skënderbeut. Dhe morën një financim minimal për sa i përket pjesës së stafit. Nuk e di si është sot nëse ka një rritje aq sa duhet të buxhetit që nevojitet për këtë shërbim, apo qoftë edhe për pjesën e shërbimit të pyjeve, apo qoftë edhe për pjesën e mirëmbajtjes apo edhe pastrimit të kanaleve e ujitës dhe kullusë që janë në qarkun e Korçës. Bashkitë kryesisht kanë. Kanë natyrë rurale bujqësore. Dhe e kanë, e kanë një çështje prioritare këtë punë. Megjithatë, nuk kryetarët e bashkive, të paktën i Korçës, nuk e kishte një problem të madh. Po ashtu, edhe Maliqi nuk pa, nuk sheh te kjo, te kjo reformë ndonjë problematikë të madhe. Dëgjova kryetarin e bashkisë Devoll që thotë: "Janë rritur të ardhurat, po pa diskutim që janë rritur të ardhurat nga 2016-ta, por po e më tani a ka mundësi të drejtë ta bëjë një koment mbas?" Po kam pra edhe pyetje, po një sekondë se unë do ta bëj një koment para se të bëj një pyetje. Ë, pyetja dhe meqë e deshe, meqë e deshe pyetje, ë, të ardhurat janë rritur si përqindjet e vjeljes së të ardhurave në raport me planin, apo është rritur dhe vlera e taksave, tarifave? Ë, ja ta mbaroj, ta mbaroj se e kam për të gjithë. Ë, dhe një pyetje që nuk e mora nga askush prej jush, ë, dhe ne duam ta dimë si Gëzimi tha që kjo nuk duhet të diskutohet. Reforma nuk do të diskutojë thjesht çështjet e territoreve. Kjo reformë do t'i diskutojë edhe çështjet e territoreve. Pa diskutim që do të diskutojë kompetencat, decentralizimin, mbështetjen financiare, por edhe çështjen e territoreve. Dhe asnjëri nga ju nuk më dha një opinion. Ne

këtu jemi për të marrë një opinion nga ju. Duhet të qëndrojmë kështu. Unë mendoj që duhet të qëndrojmë kështu. Duhet të zmadhohen ose duhet të zvoglohen, dhe në këtë presim nga ju, një opinion për të gjitha problematikat. Pastaj se çka vendos komisioni, kjo është histori tjetër, por mirë do ishte që gjithsecili prej jush ta jepte një opinion. Mendoj që bashkia Maliq duhet të qëndrojmë kështu siç është, ose duhet të ndahet në dy, ose duhet të marrë edhe ku di unë, bashkinë e një pjesë të territoreve të Pogradecit. Se mendoj që menaxhohet më mirë. Pra, një përgjigje të tillë nuk e mora.

### **Gëzim Topçiu:**

Mund të them diçka. Në fakt, unë në koment, në përgjigjen e pyetjes si Bera, shpjegova që ka dhe momente të cilat ne kemi patur vështirësi në kompetencat dhe në mbulimin me financa të disa funksioneve, dhe e shpjegova rrugët rurale, pyjet, një ndërthurje e ujitjes, kullimit, i cili, por kjo s'do të thotë që s'ka përmirësim vetëm me flotën e mjeteve që ka përmirësim të gjitha. Jo dakord, kurse për ndarjen, ndarjen administrative apo për territoret, unë e shpjegova. Nuk dua të hyj në këtë pjesë, pasi ajo duhet parë si një instrument zhvillimi për një qeveri më efikase, jo thjesht si ndarje gjeografike. Në konceptin tim, do ta jap edhe mendimin tim, patjetër. Një ndarje aktualisht duhet të qëndrojmë apo jo? Patjetër, patjetër. Unë, në qoftë se pyetja ishte direkt për këtë pjesë, patjetër mund të jepja një koncept, dhe unë konceptin e dhashë në kuptimin që edhe bashkitë të niveleve tona, që bashkia e Maliqit është në nivelet e bashkive të mesme, të themi as e madhe, as e vogël, ka vështirësi në disa piketa të cilat duhen riparë, dhe kjo mund të jetë dhe pjesë e reformës. Po themi, projektet e mëdha rajonale, projekte zhvillimi që mund të përfshijnë gjithë rajonin e Korçës, turizmin, projekte të cilat ndonjëherë një bashki e vetme nuk mund t'i bëjë dot në qoftë se s'ndërthuren në rang rajoni, dhe kjo duhet parë pastaj rast pas rasti. Për efekt të kompetencave që ne kemi sot apo kompetenca që do të shtohen, unë mendoj që pa financim dhe pa mbulim të financave të kompetencave, më mirë mos i kemi sesa na i jepni dhe i marrim ngarkesë si pushtet vendor, dhe kjo është edhe për disa që i kemi sot apo të tjera që mendojnë që mund të na shtohen.

### **Arbjan Mazniku:**

Shumë faleminderit.

### **Gëzim Topçiu:**

Për mua, bashkia duhet të rrijë bashkia e Maliqit, patjetër. Përfunduar atë që thashë më lart, që disa kompetenca duhen riparë për efekt e zhvillimit të rajonit.

### **Bledion Nallbati:**

E kuptoj, e kuptoj. Ju lutem, se nuk e opinion nga gjithsecili. Pyetjen tashi, se jam bërë burrë, tani duhet të përgjigjem 20 herë. 20 herë pyetjes. Po ta bëjmë këtë gjë. A do ta vazhdojmë debatin e ta zgjasim kohën? Kohë tani, o zotëri, është e thjeshtë. Nuk i ka vënë njeri pushkën t'i pushkatojë. Dua një opinion nga gjithsecili prej përfaqësuesve të pushtetit vendor të qarkut të Korçës. Është sukses i padiskutueshëm. Ok, por a duhet në opinionin e tyre, zotin Albatis, apo tha që është sukses i padiskutueshëm? I

padiskutueshëm është si reforma gjyqësore, si heqja e ujësjellësave. Gjithçka është një sukses i padiskutueshëm. Si zbraza, si zbraza e zonave periferike, shpopullimi i fshatrave, është një sukses i padiskutueshëm. Jo, po tani ti vetë ngacmon dhe pastaj thotë: "Japim kohën," atëherë mos më ndërr. Mos më ndërr tani.

Atëherë tani t'i përgjigjemi pyetjes. Më falni, t'i përgjigjem pyetjes.

**Bledion Nallbati:**

Si, si, si, si,

**Bledion Nallbati:**

Shpresojmë që të ketë një. Po të përgjigjesh që s'duan të ndahet. Po, patjetër, po këtë po presim. Kjo pyetje, po pse, sepse asnjëherë nuk duhet me ta thënë. Po harrova të të pyesja ty çfarë pyetje do bëj. Shiko, kur të kemi seancën tjetër, por para se të bëj pyetje, kur të kemi seancën tjetër, përpara se të bëj pyetje, do të pyes ty. Mund të, mund të përgjigjem për pyetjen e. Le këto tani. A ka mundësi të marrim një opinion? A do bëjmë reforma? A doni opinionin e kryetarëve të bashkive? Atëherë çka ke?

**Bledion Nallbati:**

S'e di, pra ti je shumë i ditur edhe e di çka kanë ata në mendje. Unë nuk e di. Unë dua ta dëgjoj nga ata dhe s'mundem që unë dua të dëgjoj opinionin e tyre. Po pres, po pres, se unë s'ia lexoj dot mendjen si ty. Ti je shumë i zgjuar e e kupton. Po tani, kaq. Hajde, mund t'i përgjigjem.

**Arbjan Mazniku:**

Zoti Duro.

**Eduardo Duro:**

Atëherë pyetjes për nivelin e të ardhurave. Unë po. Në vitin 2016, realizimi i të ardhurave është në vlerën 70 milion 212 mijë e 0.24 lekë nga 140 milion lekë që është plani. Në vitin 2025, meqë 2026 është në aktivitet, është 179 mijë 655 424 lekë nga 200 milion që është plani. Llogaritja mbetet vetë.

**Arbjan Mazniku:**

Ë, atëherë zoti Elezi, më fal, ta bëj zoti Ai.

Po, ta bëjmë me radhë. Se kush e do, se është një e kisha që të e kisha që të pari.

**Arbjan Mazniku:**

Ja doja që pari.

**Bledion Nallbati:**

Tani ka qenë 600. Nuk duhet e përmendur, po kthehem. Sa ishte? O, o, o, o, 9 milion.

**Klevis Jahaj:**

Zotin Nallbati, zotin Nallbati. Unë në burtin po pyet. O, zotin Nallbati, se. Është urdhër. Të lutem, mund ta vazhdojmë me pyetje. Faleminderit. Një ju përshtendës edhe na falni për. Ë, fakt, unë doja të bëja disa pyetje që kanë të bëjnë ndoshta dhe për të përforcuar pak dhe këto diskutimet që kemi dhe për të marrë një opinion, duke qenë se një pjesë e kryetarëve të bashkive në këtë qark kanë eksperiencë edhe nga ndarjet më parshme territoriale. Mendoni që njësi të administrative tani, ë, ose bashkitë që ju keni, keni mundësi financiare që të mbështesni njësi të administrative për të kryer shërbimet pranë qytetarëve? Dhe a ka ndikuar reforma e parë territoriale në mungesën e shërbimeve që i jepen qytetarëve në njësi të administrative dhe ish-komunave? Pra, që ta thjeshtojmë, ka shërbime që jepnin ish-komunat më përpara dhe tani nuk janë në gjendje njësi të administrative që t'i japin. Ë, cilët mund të jenë në vlerësimin tuaj shërbimet që qytetarët ende ndiejnë mungesë të përmirësimit pas reformës së re? Ë, dhe nëse ka krijuar reforma e mëparshme rritje të burokracive apo efikasitet më të madhe ndërmjet bashkisë qendrore dhe njësisive administrative që janë? Tjetër pyetje është, ë, çfarë kompetencash duhen decentralizuar më shumë sipas opinionit tuaj nga qeveria qendrore drejt bashkive? Dhe a mendoni që ka funksione të cilat, dhe në qoftë se keni shembuj të na i jepni, që mund të kryhen në nivele rajonale, jo vetëm bashkiak? Pra, në qoftë se ju keni në qarkun tuaj, do të ishte shumë mirë të na i paraqisni, ose në qoftë se keni një mendim në lidhje me këto, pra funksionet që i keni të deleguar ju si bashki, dhe në qoftë se këto mund të kenë një nivel më të institucionalizuar për të kryer shërbime në nivel ndërbashkiak rajonal sesa vetëm në një bashki të ndarjes aktuale. A mendoni se ka territore të cilat kanë mbetur jashtë reformës së parë, pra që mund të kenë një afërsi të caktuar dhe duhen sistemuar në këtë reformë? Ka raste të tilla në bashkitë tuaj, pra zona, fshatra, krahina, minoritete të cilat duhet të jenë pjesë e një bashkie aktuale ose shërbejnë nga një bashki e ndryshme? Kaq kisha. Faleminderit.

**Arbjan Mazniku:**

Faleminderit. Ë, pyetje përgjigje, lutem, zoti Filo, pastaj kryetarët me radhë sipas.

**Sotiraq Filo:**

Unë po ju përgjigjem disa prej pyetjeve, se disa duhen më shpëtuar. Nuk arrita t'i mbaja dot shënim. Atëherë, po ja, kushdo ngelet pa përgjigje. Ë, pyetja e parë ishte në rast se ka disa shërbime që ofroheshin më mirë nga ish-komunat dhe më keq nga bashkitë. Jo, në dijeninë time, nuk ka ndonjë shërbim që të jetë ofruar më mirë nga ish-komunat dhe më keq nga bashkitë e mëdha. Ë, shërbime administrative që mungojnë, në sensin për shkak të kompetencave. Ë, atëherë po i përgjigjem kësaj pyetjes që ishte çfarë kompetencash mund të decentralizohen akoma. Njëra shumë e rëndësishme, ta themi që në fillim, e tha dhe Gëzimi, e thashë dhe unë, ë, kompetenca që decentralizohen pa mbështetjen e duhur financiare, jo, sepse janë pastaj në barrë. Do të duhet të heqim burime financiare nga plotësimi i shërbimeve të tjera për investime të tjera dhe nuk do t'i

bëjmë ashtu siç duhet. Pra, është shumë e rëndësishme që kompetencat shoqërohen me burimet e duhura financiare. Me këtë kusht, unë besoj që bashkitë i kanë kapacitetet që një pjesë të kompetencave që janë ofrohen akoma në nivel qendror, të ofrohen në nivel bashkiak, pasi besoj që duke qenë më afër qytetarëve, dhe ky është edhe kuptimi, prandaj thonë edhe niveli i parë i pushtetit vendor, duke qenë më pranë qytetarëve, realisht jemi më të prirur, mendoj, që të jemi më proaktivë edhe më të, ë, më të gatshëm për t'i realizuar më mirë kompetencat. Po, gjithnjë në rast se kemi burimet financiare të duhura. Dhe për të folur më konkretisht, ë, disa nga kompetencat që mund të decentralizohen akoma janë ato që lidhen me shërbime të cilat i kemi të ndara. Pra, akoma një pjesë kompetenca si i ka pushteti qendror, një pjesë i kemi ne, dhe kjo lë vend për keqkuptime edhe për t'ia lënë njëri-tjetrit. Konkretisht, pjesa e vaditjes së kullimit, e përmendi dhe Gëzimi, një pjesë e kanaleve të vaditjes së kullimit, kanalet e para, lumenjtë kryesisht, edhe kanalet e mëdha të vaditjes janë përgjegjësi administrimi e bordeve të kullimit. Ndërkohë, ne kemi kanalet e dyta, të treta. Tani, çfarë do bëj unë me kanalën e dytë, të tretë? Mund të investoj sa dua, ta mirëmbaj sa dua, po qe se dështon bordi i kullimit të më lëshojë mua ujin në kanalën kryesor, unë s'kam çfarë bëj. Ose e njëjta gjë vlen edhe kam pasur dhe rast konkret me këto situatat e përmbajtjeve. Porta në një lumë në territorin e bashkisë tonë, lumin e administron bordi si lumë, ndërkohë ngecëm në kjo pjesë ore kush duhet të merret me menaxhimin e portave. Bordi thoshte e ka bashkia, sepse pjesën e vaditjes e ka bashkia. Ne thoshim ore lumin e keni ju. Pra, këto mund të shihen për t'u decentralizuar, mendoj unë. Kompetencat që janë mikse për të plotësuar një shërbim, kompetenca të ndara, ato mund të tentojnë të kalojnë në një drejtim, o të decentralizohen tek bashkitë, o të centralizohen përsëri, se duke qenë kështu të ndara, lë vend për problematika. Po, është shumë e rëndësishme mbështetja financiare. Territore që duhen sistemuar nga reforma e parë, jo në sensin e ndonjë krahine që t'i takojë historikisht, kulturalisht, një bashki dhe të ketë ngecur tek bashkia tjetër. Dhe për t'iu përgjigjur edhe pyetjes së Bledionit, se ju përgjigjja vetëm pyetjes së parë për suksesin apo problematikat e reformës, jo për reformën që po vjen, unë mendoj që mund të ketë vend për të analizuar edhe thellimin e mëtejshëm të reformës në drejtim të përqendrimit të territoreve, por mendoj që duhet të shoqërohet me një vëmendje në legjislacion për t'iu dhënë kompetenca pak më të mëdha, mbase dhe mënyra e zgjedhjes të administratorëve të ardhshëm të jetë mbase nëpërmjet një lloj votimi, sepse duke qenë i zgjedhur me votë, siç janë kryepleqtë, pra metodika e kryepleqve mund të shtrihet edhe në nivel të administratorëve. Mund të ishte një sugjerim në rast se territori bëhet akoma më i madh, që të ruhet një lloj lidhje direkte e atij administratorit nënkryetar dhe bashkisë me banorët e atij territori të caktuar, sepse fatkeqësisht kemi një problem mentaliteti në Shqipëri që një banor i një fshati X, në rast se ka një problematikë të caktuar, nuk e konsideron të ezauruar përgjigjen që merr për atë problematikë, po qe se nuk takon edhe të madhin fare, që është kryetari i bashkisë, dhe mund të vijë tek unë dhe në shumicën e rasteve merr të njëjtën përgjigje që i ka dhënë dhe administratori, ama do ta ezaurojë këto hallka. Kjo është një gjë, kjo është çështje mentaliteti, çështje mënyre të vepruarit për një kohë të gjatë dhe mbase është vështirë të ndryshojë, por për mua ka vend për thellimin e reformës. Duhet pasur kujdes në këtë nivelin e dytë të administratorëve. Kaq.

## **Arbjan Mazniku:**

Zoti Topçiu.

## **Gëzim Topçiu:**

Unë mendoj që ka vend për decentralizim dhe dhënie funksione tek pushteti lokal, pasi të gjithë shqetësimet që dalin në komunitet, edhe pse ato mund të jenë kompetenca të pushtetit qendror, qytetarët duan ta marrin shërbimin apo e sjellin shqetësimin tek ne, edhe pse ne mund të mos kemi palën në dorë për atë lloj kompetence. Kështu që unë do sugjeroja që reforma duhet të thellohet në arsim, në shëndetësi. Në arsimin ne kemi një eksperiencë shumë pozitive me arsimin parashkollor dhe tashmë që funksionon edhe portali si për parashkollorin, si për mësuesët, si për infermierët, pse mos realizohet kjo prej pushtetit lokal dhe aty t'i jepet më afër qytetarëve sesa për të ndërruar një infermier, për të ndërruar infermieri është më keq, apo një mjek, duhet të ecë një karvan i gjatë nga drejtori, nga qendrat shëndetësore në drejtori rajonale, të vijne drejtorit në Elbasan, të vijne në ministri, edhe ndonjë dy-tre muaj të ndërrohet një infermier apo një mjek, dhe kjo kompetencë mund të zgjidhet shumë shpejt. Biles, në momentin kur kemi vështirësi edhe në mjek, unë mendoj që nuk duhet të ketë më drejtorë të qendrave shëndetësore në çdo njësi administrative, kur mund të jetë një drejtorie e shëndetësisë në rang bashkie dhe ajo të menaxhojë gjithë qendrat shëndetësore që ka komplet bashkia apo territori, dhe kjo do të ishte një lehtësi shumë e madhe dhe një shërbim shumë i madh edhe për qytetarët. E njëjta gjë mund të ndodhë për arsimin, për arsimin, pasi edhe këtu ka vështirësi. Biles, ajo që ne diskutojmë është që edhe mësuesët nuk duhet të hyjnë në portal për tre-katër zyra arsimore, se edhe kjo krijon një rrëmujë të madhe, por të hyjnë vetëm tek bashkia që ato mendojnë që mund të punësohen edhe të shërbejnë për atë komunitet. Një moment tjetër që ndonjëherë ta diskutoja ka të bëjë me buqësinë me atë të kanaleve që tha edhe kryetari i bashkisë së Korçës. E kemi pasur problem, kolektorët kryesorë për ne janë problemi më i madh, i cili na shkakton probleme edhe në kanalet e dyta e treta. Le t'i pastrojmë ne, t'i mbajmë të pastër, në qoftë se kemi një anomali në lumenj apo në kanale, gjithë puna jonë bie poshtë, edhe pse qytetarët mendojnë që ne e kemi fajin, pavarësisht kjo ndërthurje që ka një mbivendosje të kompetencave. Agropikat edhe sportelet që janë për buqësinë në qendër të qarkut, unë them do të jenë pranë bashkive. Qytetarët t'i gjejnë aty për efekt aplikimeve në buqësi, në blegtori, të jenë sa më afër nesh dhe të kenë edhe shërbimin këshillimor të agronomëve që ne nuk e se si kemi nëpër bashkitë tona. Pastaj, për projektet rajonale, ajo që e ngrite pak më herët, ajo duhet parë me kujdes. Unë mendoj që emergjencat civile apo zhvillimet rajonale duhet të kenë një strukturë diçka më lartë që duhet të ndërthurin. Ndoshta të gjitha bashkitë dhe mos jenë pjesë e një bashkie të vetme, pasi unë them se këtu pastaj do shikohet më e copëtuar dhe po u bë rajonale, do ketë një impakt më të madh. Shumë faleminderit.

## **Arbjan Mazniku:**

Faleminderit, zoti Topçiu, për kontributin. Në fakt, për të gjitha sugjerimet që bëtë për elementet të decentralizimit ekstra, do na vlenë shumë. Ne kemi lënë një takim tashmë, eventualisht kur të mbarojnë dëgjesat, me formalisht me shoqatën e bashkive, me

shpresën që aty do marrim disa pozicione formale të bashkive në formë të organizuar, jo si bashki specifike për rastin tuaj, por për bashkitë në tërësi. Do na vrente shumë që këto sugjerime t'i marrim në formë shtresore, eventualisht kur të kemi dhe takimin me të gjitha tjerat. Ëh, po, zoti Dura.

**Eduardo Duro:**

Atëherë, pyetjes për numrin apo llojin e shërbimeve që ofroheshin nga njësi administrative, kjo edhe për shkak të reformës të vitit 2014, numri i shërbimeve në njësi administrative që nuk ofroheshin nga ish-komunat është të rritur, jo më ato shërbime që të cilat. Kurse për pjesën e propozimeve, unë, sepse nuk dua të përsëris kolegët e mi, sepse problemet janë pothuajse të njëjta, unë do të vija theksin thjesht në rritjen e përqindjes të transfertës së pakushtëzuar për bashkitë në buxhet, dhe ajo pastaj zgjidh edhe problematikat e tjera. Sasinë e pushtetit vendor kemi vetëm 1% të buxhetit të përgjithshëm. Kështu që minimumi, ne kemi bërë dhe propozim zyrtar në shërbim. Minimumi duhet të jetë 2%, pastaj të shohim me rritje graduale çdo vit. Ky është propozim që ne kemi bërë dhe zyrtarisht, kështu që nuk është se duhet ta fshehim.

**Arbjan Mazniku:**

Faleminderit, zoti Kolefski.

**Pali Kolefski:**

Ëh, kryetar Gëzimi i tha pothuajse të gjitha. Unë mendoj vetëm se doja të shtoja varet edhe nga specifika e bashkisë. Për shembull, në bashkinë tonë ne kemi një liqen shumë të bukur, i cili administrohet nga ose të gjithë shoqata e peshkatarëve administrohet edhe menaxhohet nga Ministria e Bujqësisë. Unë mendoj që ky kompetencë duhet t'i kalojë bashkisë patjetër. Do të ketë më shumë akses bashkia që në mënyrë që të nxjerrë disa të ardhura. Edhe një funksion tjetër do të propozoja edhe për punën e legalizimeve. Legalizimeve, mendoj se bashkitë janë më pranë problematikave, patjetër që duhet të monitorohen nga pushteti qendror, por duhet t'i jepen më shumë kompetenca që ky proces të përfundojë njëherë e mirë. Ëh, dhe për sa i përket pjesës së pyetjes së parë, bashkia e pushtetit bën, siç theksova, bën pjesë në ato bashki minoritare. Nuk besoj që kjo reformë që të prekë këtë bashki.

**Arbjan Mazniku:**

Ëh, po.

**Bashkia Kolonjë:**

Në vija të përgjithshme, po jap përgjigje për pyetjet që ushtruan. Sa i përket bashkisë së Kolonjë, nuk mund të them absolutisht që komunat ofrojnë diçka më tepër nga shërbimi që aktualisht bashkia Kolonjë ofron dhe për më tepër që janë rritur numri i shërbimeve për të ardhur më pranë komunitetit, qoftë ata që jetojnë në hapësirat rurale, qoftë ata që jetojnë në dy hapësira urbane, që është qyteti Ersek edhe Leskovik. Diçka që doja të

shtoja sa i përket funksioneve rajonale, mendoj që duhet të jetë ose duhen parë në një qasje më rajonale, pikëpamje siç janë turizmi, njëësia e integritit europian, sepse qasja që duhet të jepet patjetër që gjithnjë e më tepër, të paktën qarkullor, po sheh këtë pikëpamjen se si ne mund të futemi në tregun e turizmit si qark dhe jo si bashki, dhe prandaj dua të them që vetëm detajet e imta, po themi, të turizmit apo të projekteve të huaja mund të shihen në këtë qasje rajonale. Ëh, nga ana tjetër, mund të nënvizoja faktin se si disa detaje që mund të decentralizohen. Ëh, bashkia e Kolonjës ishte pjesë e projektit pilot për arsimin parauniversitar që të shikohet, pra një nga katër bashkitë që u trajtua si projekt pilot për t'u parë se si do të mund të menaxhohet arsimi parauniversitar nga bashkia apo jo. Pati patjetër problematika, po nga ana tjetër mund të them që po, duhet vëmendje shtuar se si në rastin konkret arsimtarët lokal, po themi këtu vendas, t'i japin shërbim dhe kontributin e tyre për hapësirën Kolonjë dhe jo të vijnë djesh nga bashkia Korçë në rastin konkret për të mbushur hapësirat që shumë mirë mund të plotësohen nga arsimtarë apo mësues të bashkisë së Kolonjës. Këto detaje desha të shtoj. Faleminderit.

### **Arbjan Mazniku:**

Faleminderit. Ka dikush nga të tjerët? Kemi pyetje, zoti Mziu.

### **Xhelal Mziu:**

Faleminderit, kryetar. Ëh, normalisht në gjithë debatin që ne bëjmë, nxjerrim pa problematikën të cilat shkojnë në drejtim të qytetarëve për t'iu ofruar më shumë shërbime, më shumë investime dhe për ta mbajtur të lidhur me territorin. Sepse nuk është se ka prodhuar kjo reformë territoriale një zgjidhje për shqiptarët, se mjafton vetëm po të shohësh në këto 10 apo 12 vitet e fundit, kemi një ikje masive ku jo pak i dedikohet reformës territoriale. Po mor rasti i Maliqit është një rast tipik politik që një bashki si bashkia e Maliqit bën kalkulime politike dhe është ndoshta e vetmja bashki në Shqipëri që kufizohet me qarkun e Elbasanit, kufizohet me qarkun e Beratit, kufizohet me të pesë bashkitë e tjera dhe shkon e kufizohet edhe me Maqedoninë e Veriut. Se i duhej me patjetër të ngjitej Poiani në një zonë që mund t'i prishte punë Korçës apo Devollit apo diku tjetër, ja bashkangjitën Maliqit edhe po ta shohësh në aspektin pamor në hartë, është një kështu drejtkëndësh, po themi, që kalon tej e tej territorit dhe i vendos qytetarët në kushte absolutisht anormale. Imagjino një qytetar, po themi, që është në kufi me Skraparin dhe Gramshin dhe një qytetar që është me Devollin apo me Postesë apo si e ka emrin ajo, apo Maqedonia e Veriut, apo me Pogradecin, se çfarë lloj kohezioni kanë që do të ishte absolutisht normale që të ishte, bie fjala, bashkia e Leskovikut. Duan me dhjetëra kilometra për të shkuar nga Erseka në Leskovik. Kam patur fatin disa herë për të shkuar, ka qenë një qendër shumë e rëndësishme, jo më pak e vogël sesa, ëh, po themi, disa bashki të tjera të qarkut të Gjirokastrës, për të vazhduar, po themi, me, ëh, me Poianin që s'kishte nevojë me i bërë një zgjatim me pjesën e Maliqit, por mund të ishte një bashki në vete për të vazhduar, po themi, me Voskopojë, një qendër shumë e rëndësishme, po themi, turistike dhe nuk kishte pse të ishte në menaxhimin e Korçës, sepse do të krijonte vërtetë një, ëh, situatë, ëh, për ta përthithur edhe më shumë, sepse edhe paratë do të përqendroheshin fiks në atë zonë, apo mund të ishte dhe Drenova, një tjetër bashki që do

të bënte disa qendra urbane dhe ajo çfarë është më kryesorja që këto janë shqetësime jo të miat personale, por të qytetarëve, madje duke marrë shkak dhe nga një reformë që nuk u konkretizuar tre vite më parë, sepse nëpërmjet kësaj reforme centraliste janë krijuar probleme të cilët, ëh, nuk janë probleme që kanë ndikuar tek një kryetar bashkie, as tek një deputet, as tek një rrogëtar, po kanë ndikuar fiks tek qytetarët, sepse thjesht ajo distanca e largët me qendrën e ka pamundësuar shërbimin dhe jam absolutisht i bindur që kjo reformë territoriale e cunguar në kaq pak ngastra apo njësi në gjerdani ose gjashtë apo shtatë herë më pak sesa ishin, ka luajtur rol negativ për buqësinë. Ka dhe në qarkun e Korçës, si shquhej një ndër qarqet që nuk linda asnjë sipërfaqe toke pa mbjellur, se mbjell kush tokën më. Pra, ka rrënuar buqësinë, ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë tek arsimit, se kur fillon zbrazja e ikjes së disa familjeve dhe pastaj ti do të dërgosh një furgon për t'i transportuar nja shtatë orë apo 10 orë për t'i dërguar te shkolla fqinje apo e një njësi e tjetër apo ish-komune tjetër dhe që i shtyn nxënësit me shkelma për t'i futur brenda në furgon, kush është ai prind që detyrohet për të ndenjur më aty, sepse fëmijët janë e ardhmja dhe ato gjejnë një zgjidhje ose vijnë në Tiranë ose ikin jashtë. Pra, kjo është mbyllja e arsimit. Një tjetër element, shëndetësia, qendrat shëndetësore janë tamam si ato gabinat elektrike që nuk funksionojnë. Gjithsecili don që ta ketë shërbimin sa më afër. Për të shkuar tek investimet, më vjen shumë keq që, ëh, të gjithë referencat që i morët, morët. Është rritur, po themi, vlera e investimeve. Pse gënjeni se është rritur vlera e investimeve? Se ti, kur të thuash se është rritur vlera e investimeve, duhet të bësh një krahasim dhe ju sfidoj edhe ju si qark për të krahasuar se si kanë qenë investimet kur ishin, ëh, sipas standardit me 373 njësi vendore, siç kishte Korça. Në përqindje, në raport me totalin, është përgjithësuar investimet në rang shqipërie. Në përqindje ka qenë 36.5%, ka rënë në 18% dhe nuk flitet me miliona me gjëra, se, ëh, nuk po llogarisim inflacionin e të tjera gjëra që vijnë, por është shqetësuese kur në 100 lekë që paguajnë taksat, taksapaguesit e bashkive tuaja, vetëm 18 lekë shkojnë për investime kapitale dhe më shumë sesa 46.5 lekë shkojnë për paga dhe sigurime shoqërore në rang shqipërie, se ka dhe mbi 50% bashki që dërgojnë për paga dhe sigurime shoqërore dhe natyrisht një pjesë e vogël që ngelet, po themi, shkon për shpenzime operative apo sociale. Kjo është situata që është krijuar dhe shihet në aspektin makro që ka krijuar. Pra, të përgjithësohet investimet, ato që kanë nevojë qytetarët dhe le të thotë secili kryetar bashkie e sheh dot, po themi. Dhe Korça e sheh njëlloj si Voskopojën, si Korçën. Edhe unë, po të isha, nuk do ta shihja njëlloj. Do të shoh qendrën e kryeqytetit, e bashkisë dhe që të ngelet, do ta nisë drejt zonave përreth. Kurse nëse do të kishte më shumë, do të krijoheshin më shumë qendra. Do të kishte patur më shumë zhvillim Voskopoja, po të ishte në vete. Do të kishte patur më shumë zhvillim Poiani, po të ishte në vete. Do të kishte pasur më shumë zhvillim Leskoviku dhe joshpopullim, nëse do të kishte qenë në vete. Pra, reforma ka dhënë efekte negative në buqësi, në arsim, në shëndetësi, në shpopullim. 1.2 milion, sipas statistikave, dhe tani që bëri Eurostat një tjetër statistik, ishim me dy, tre herë më shumë sesa vendi i dytë. Të parët në Evropë përse i përket eksodit, jo pak rol luan, po themi, ëh, centralizimi i pushtetit vendor. E kam thënë dhe me të tjerët: 6.000 banorë për njësi vendore ose për bashki në Evropë është mesatarja. 70.000 e keni dërguar partia në pushtet dhe tenton për ta zvogëluar dhe më shumë. A do ishit dakord ju? Po themi që hajde le të bëjmë një, ta

bëjmë një. Po s'ka problem ti se je, je ke dalë në pension, në atë pozicion pune dhe nuk kupton ti.

### **Luçiano Boçi:**

Zoti Topçiu, a ka mundësi? Ja një minutë, një minutë. Këtu je në komision parlamentar. Të lutem shumë, se e di që e di. Dhe një herë tjetër, prevalon, prevalon në komision parlamentar fjala e deputetit. Si e bën ai pyetjen dhe si bën parashtrimin, nuk ndërhyti ju fare. Ju, kur t'ju jepet e drejta e fjalës, mund t'i jepni përgjigjen tuaj. Tani s'jemi në kafe.

### **Arbjan Mazniku:**

Dorëruajmë një të drejtë, lutem, dhe kur të japim përgjigjen e fjalës, që mos i ndërhyjmë, se i ndërhyjë shpart deputeti 10 herë ke fjala. Kështu që duke. E pyetja dhe të kryejmë pyet të gjitha.

### **Xhelal Mziu:**

Ato që ngrita unë ishin pyetje, po nuk e kuptoj. Mos don t'i them unë vendos pikëpyetje? Besoj që efektin negativ që ka dhënë te buqësia, shënoje zoti Topçiu. Efektin negativ që ka dhënë te arsimit, shënoje zoti Topçiu. Efektin negativ që ka dhënë në shëndetësi, shënoje. Efektin negativ që ka dhënë në shpopullimin. Efektin negativ që ka dhënë në zhbërjen e qendrave, të zonave të cilat kanë qenë që nga Leskoviku, Poiani apo të tjera, të cilët unë i thashë pak më përpara, që nuk janë më qendra. Nuk i sheh më kush, sepse nuk ka mundësi, po themi, për ta mbajtur infrastrukturën. Një pyetje tjetër kisha: A jeni të kënaqur me këtë 1% që merrni? Se më përpara mbaj mend ka qenë me 1%, jepeshin dhe ca grante konkurruese dhe diferenca jonë me vendet dhe rajonet, me Bashkimin Europian, është me dy herë më pak sesa rajoni, katër herë më pak sesa Evropa. Jeni të kënaqur me këtë 1%? Tjetër: A jeni të kënaqur ju me taksën e biznesit të vogël? Vetëm në 2013 ka dalur, po themi, taksa e biznesit të vogël zero. Po ajo taksa e biznesit të vogël shkonte tek, ëh, pushteti vendor dhe krijoheshin ca të ardhura. E dinë shumë mirë ju që keni qenë. Po pra, taksa e biznesit të vogël. Jo, jo, taksa e biznesit të vogël që paguante biznesi i vogël. Dhe unë mund... Qeveria ka të drejtë. Një sekondë. Qeveria ka të drejtë që të bëjë politikë, që t'ia falë taksat e biznesit të vogël, por nuk ka të drejtë që të denigrojë pushtetin vendor. Dhe më thoni ju, se edhe unë kam qenë në këtë bashki, 0 lekë na subvencionoi buxheti i shtetit. Kur ti bën një politikë sociale dhe që cënon xhepin e pushtetit vendor, duhet t'i japësh kompensimin. Keni bërë ndonjë lekë për pushtetin vendor ju? Si pushtet vendor nga taksa e biznesit të vogël? As në mënyrë drejtpërdrejtë se e ka zeruar qeveria, nuk është subvencionuar nga buxheti i shtetit, siç ndodh kudo nëse politika qeverisëse ndryshon modulën e saj. Absolutisht do të ishte zhvilluar më shumë biznesi nëse do t'ua kishte paguar ato taksat ju, sepse do t'i kishit bërë më shumë rrugë, do t'i kishit bërë më shumë kanalizime, ujësjellës, ndriçim, etj., të tjera probleme të cilat ka sot pushteti vendor. A jeni të kënaqur ju, po themi, me kompetencat që keni? Çfarë kompetencash keni ju? A keni zyra kadastrë? A keni zyra, ëh, legalizimesh? A keni të drejtë pronësie mbi tokën që

ju administroni si kryetar bashkie? Nuk i keni asnjërën nga këto. Dhe pyetja ime është: Do të e doni dhe ju, si të gjithë vendet e rajonit dhe të Evropës, që të keni kadastrën urbane aty? Që të keni legalizimet aty? A merrni nga taksat kombëtare rentë minerare apo të tjera, të cilat i morin të gjitha vendet e rajonit, duke filluar nga Maqedonia e Veriu, që është në kufi me ju, Greqia e me radhë? Merrni nga këto taksa? Është një praktikë që e përdorin të gjitha vendet e rajonit të Bashkimit Europian për ta ndihmuar pushtetin vendor, për ta bërë efektiv, për të energjizuar situatën në atë territor dhe për të qenë edhe bashkëpunues. Po çfarë bashkëpunuesi mund të jetë pushteti vendor kur s'ka asnjë lloj kapaciteti tek një minierë, tek një hidrocentralë apo çfarëdo lloje e ardhur kombëtare që prodhohet në territorin tuaj dhe 0 lekë merrni? Ka dhe të tjera probleme të cilat besoj që ju i dini. Ka dublim kompetencash. Ka IMT për një ndërtim, ka IKMT, ka AZT, ka dhe polici. Pra, nëse dikush në bashkinë që ju drejtoni, nuk mjafton vetëm inspektorati i ndërtimit që keni ju, i mbrojtjes së territorit, po vjen dhe nga qendra, vjen dhe AZT-ja, po qe se keni kulla nga tek filo duhet të shkojnë ato që japin kulla në Korçë, se këtë tjetër punë s'ka filluar akoma, vjen dhe policia. Pra, s'keni një kompetencë. Tjetër, në delegimin e kompetencave që është bërë, a mjafton financat që i ka deleguar qeveria, po themi, për pyjet, për Bordin e Kullimit, për zjarrfikëset, për mirëmbajtjen e rrugëve? A mjafton? Nëse mjaftoni, okej, po unë të paktën kam qenë kryetar bashkie, e di problematikat që ka një bashki që ka nevojë për para. Pra, shtylla kryesore është pavarësia. Shtyllë tjetër është delegimi ose financat dhe tjetra që është sfidë kudo në botë, decentralizimi për t'i shkuar sa më afër qytetarëve. Këto ishin disa nga shqetësimet. Do të doja opinionin tuaj nëse mund të kontribuoni, por këto që unë thashë nuk janë, nuk kanë ngjyrim politik, janë probleme të cilat të paktën kam patur mundësinë për t'i ngritur dhe atëherë. I kam ngritur me çdo forcë politike atë se çfarë i takon për të patur pushtetin vendor që është më afër qytetarëve dhe që zgjidh problemet e zonës në kohë reale. Faleminderit!

#### **Arbjan Mazniku:**

Faleminderit! Po, zoti Topçiu.

#### **Gëzim Topçiu:**

Unë dua të sqaroj, në fakt, zoti Mziu ka qenë vetë kryetar bashkie dhe patjetër di edhe shqetësimet edhe problemet që ka çdo kryetar bashkie që do të bëjë sa më shumë punë, sa më shumë investime, të jem sa më afër komunitetit, por mendoj që informacioni që kishte në lidhje me Bashkinë e Malit që nuk e ka saktë, pasi Bashkia e Malit që të vërtetë ka shtatë njësi administrative, por përjashtuar Moglicës, e cila ka një largësi të konsiderueshme nga qendra, të gjitha njësitë Poiani, po themi, është vetëm 50 km nga qendra e bashkisë, nga Maliqi. Po Poiani më afër Devollit, Korçës apo Kryqit, apo Kollëngradecit? Maliqin kam afër. 100%. Tani, e kemi në këtë debat se e kemi bërë këtë debat. Zoti Mziu, e kemi bërë këtë debat edhe njëherë. E kemi bërë këtë debat edhe para ca kohësh. Po ju them që informacionin që keni nuk e keni të saktë, se na dëgjojnë dhe qytetarët dhe unë s'kam si të gënjej. Poiani është vetëm 15 km. Të thaja pse i kam nxjerrë shifrat se e dija që vreshtasja është 19 km. Kush? S'kemi me pushtetësin jemi. Ka 15 km është Gora dhe nuk kemi kufi as me Elbasanin, as me Maqedoninë, as me kemi kufi

brenda bashkive të qarkut. Kemi Gramshin. Po, kemi Gramshin. Gramshin është me Moglicën, po s'do të thotë ndonjë. Bashkia e Qarkut Elbasan bashkëqark Elbasan. Ah, atëherë Moglica, e cila është njësi shumë e vogël administrative, nuk ka lidhje me Gramshin. Megjithëse unë nuk dua të diskutoj fare. Bashkëqark Elbasanit dhe në mënyrë eksplicite thashë Gramshin. Qarku i Beratit dhe në mënyrë eksplicite Skrapaj. Jam shumë dakord. Atëherë po të them asnjë nga. Dhe kufizohet dhe me Maqedoninë. Asnjë. Jo, nuk kufizohet me Maqedoninë atëherë. Nuk kufizohet më. Dëgjo, të lutem se. Asnjë. Mos bëjmë debat tani. Zoti Mziu. Ëh, se na e tha kryetar Boçi që bëmë pyetjen me të gjithë kohën që duhet, pa ndërprerë njeri. Tani do të dëgjojmë kryetarët të bëjmë pyetjet që kemi ndaj nata. Asnjë nga njësitë që janë pjesë e Bashkisë së Malit nuk kanë të bëjnë me qarqe të tjera, por kanë qenë pjesë e Qarkut të Korçës. Nga ana tjetër, dua të sqaroj edhe dy-tre momente në lidhje me buqësinë, me shëndetësinë, me arsimin, e cila buqësia ka marrë një... nuk ka në fushën e Korçës toka të pambjella. Nuk ka në fushën e Maliqit toka të pambjella dhe. Janë të gjitha të mbjella në çdo... në çdo cep. Ata kërkojnë patjetër nga ne mbështetje financiare, investime në ujitje, në kanalizime e të tjera, për të cilat një flotë që qeveria qendrore ne na i ka dhënë. Kemi katër ekskavatorë që i pastrojmë 900 km kanale që ka Bashkia e Maliqit për të dytën e për të tretën herë. A ka probleme? Unë e citova pak më parë: ne dublimi i kanaleve të para apo kolektorëve apo lumenjve, të cilat na krijojnë disa probleme, por kjo s'do të thotë që ne të mos marrim përsipër atë përgjegjësi që ne kemi. Ne po, e kemi ngritur si shqetësime, ngrim prapë kanalet kulluese. O duhet të na kalojnë ne të gjithë, o duhet t'i marrë një strukturë rajonale, e cila të mbajë përgjegjësi që nga grykderdha deri tek ujitja e fermerëve. Nga ana tjetër, për arsimin, patjetër unë nuk mund ta marr në konsideratë atë që tha të paktën më parë, pasi edhe investimet e qeverisë qendrore në arsimin e mesëm, me palestra, me terrene sportive, me shkolla, duhen vlerësuar. A ka probleme në shkolla të vogla në zona rurale? Patjetër që ka, por në të gjitha fshatrat, edhe aty ku ka dy nxënës, sot vetëm mësuesi edhe e zhvillon mësimin sipas kurrikulave dhe programeve mësimore të miratuara nga Ministria e Arsimit. Shëndetësia e shpjegova pak më lart. Përveç asaj që unë mendoj që duhet të ketë një drejtim rajonal ose në rang bashkie dhe të mos merret çdo qendër shëndetësore të ketë drejtorinë vete, por të merret pasinë para reformës, qendrat shëndetësore i kemi patur ne edhe për mirëmbajtje e për të tjera, dhe unë mendoj që në atë periudhë ky shërbim është kryer më mirë se tani. Shumë faleminderit!

**Arbjan Mazniku:**

Faleminderit! Zoti Filo.

**Sotiraq Filo:**

Po, mirë, shumë shkurt, domethënë, u përmend bujqësia si një fushë ku reforma ka prodhuar efekte negative. Në fakt, bujqësia është shembulli më tipik, infrastruktura bujqësore, ku reforma ka patur impaktin më të madh. Dhe me infrastrukturë bujqësore kam parasysh kanalet e vaditës, kanalet kulluese, rrugët e parcelave. Falë edhe mbështetjes së qeverisë me mjete, kemi bërë punë sa nuk kishin bërë në 20 vite e kusur më përpara dhe janë pastruar kanale që nuk kishin nxënë me dorë. Dhe për këtë ju ftoj

vetë grup të majtë, të djathtë, të vini dhe të pyesni fermerët: cila ishte gjendja e infrastrukturës bujqësore kanaleve të vaditës, kulluese, rrugëve të parcelave? Dhe po them edhe një shembull që duket si shaka, por është e vërtetë. Në një nga këto dëgjesat tek fshati i Dvoranit, Mollajt, një nga ata fermerët më ankua, më tha: "Tani, për shkak se janë shtruar rrugët e parcelave, na ikin me shpejtësi me vetura dhe na plurosen mollët, ndërkohë që më përpara nuk hynim dot me zetorë." Dhe ka qenë ngjarje reale. Pra, bujqësia është nga infrastruktura bujqësore, është shembulli tipik se si reforma ka prodhuar efekte pozitive. Për sa i takon, u përmendën dy fshatra ose dy njësi: Drenova dhe Voskopoja. Nuk e di, mua s'më është ankuar njeri ndonjë banor të më ketë kapur dhe të më ketë thënë që kemi qenë më mirë kur ishim njësi dhe jemi më keq tani që jemi bashki dhe duam të ndahemi, të kalojmë përsëri në njësi. Dhe Voskopoja është fshati që ka marrë sasinë më të madhe të investimeve në fshatrat e Bashkisë së Korçës. Praktikisht është bërë çdo gjë e re: 25 m2 kaldreme, ndriçimi publik i gjithi i bërë, i ri, qendër shëndetësore e re, shkollë e re. Nuk di se çfarë ka ngelur pa u bërë në fshatin e Voskopojes. E njëjta gjë vlen edhe për Drenovën. Po, Voskopoja është kampion. Nuk e di kujt ju çfarë konsiderate dhe nga kush e ka marrë deputeti këtë faktin që ankohen banorët e Voskopojes që janë bashkuar me Bashkinë e Korçës. Këto doja. S'dua të zgjatem tepër.

**Arbjan Mazniku:**

Zoti Dura.

**Eduardo Duro:**

Unë do të evidentoj vetëm thjesht nivelin e investimeve. Atëherë unë po them që nuk po hyj në shifra. Bashkia e Devollit ka 43 fshatra dhe qytetin. Në vit nga viti 2019 që unë drejtoj Bashkinë e Devollit, nga 43 fshatra ishin me ujë të pijshëm 20 fshatra. Nga 2019 dhe sot, 43 fshatrat e Bashkisë së Devollit janë me 24 orë ujë. Ky është niveli i investimeve në ujësjellësa, niveli i investimeve në rrugë rurale. Devolli i Sipërm, që është njësi administrative më e madhe rurale në Devoll, në vitin 2019 nuk kishte asnjë kilometër rrugë të asfaltuar rurale. Sot ka 24 kilometra rrugë rurale të asfaltuara. Kaq.

**Arbjan Mazniku:**

Faleminderit, zoti Kolefski.

**Pali Kolefski:**

Nuk është se kam ndonjë koment, vetëm thjesht do të përmend një vlerë, një shifër. Në 35 vjet, Bashkia e Pushtetës së Komunës Liqenës së Dikurit, domethënë, ka problem, ka qenë uji i pijshëm. Me dhënien e kompetencave, po them sot, mbas kaq vjetësh, në 2020-ën, mos gabohem, 2020-në fiks, ka përfunduar me shumë sukses i gjithë rrjeti i kanalizimeve për çdo banor, edhe në shtëpinë më të largët, 24 orë uji. Nuk besoj që me ato kompetenca që kishte Bashkia ose Komuna atëherë, e me ato, me atë stafin që kishte, që mund të menaxhonte një projekt të tillë. Faleminderit

**Arbjan Mazniku:**

Zoti Kolefski. Kolonja.

### **Bashkia Kolonjë:**

Meqënëse u theksua disa herë Bashkia Leskovik, më lipset nevoja që të përmend disa detaje për këtë fragment. Që tendenca e popullsisë, sidomos pas ndryshimeve dhe tranzicionit politik, ka qenë gjithmonë nga periferia drejt qendrës, padyshim ky është një proces që nuk është ndaluar aq më tepër nga reforma territoriale, por çfarë mua më duhet të theksoj, se nga kalimi i Bashkisë së Leskovik në njësi administrative Leskovik, diferenca është shumë e dukshme, edhe nëse secili nga panelistët apo pjesëmarrësit në këtë tryezë kalojnë për një udhëtim turistik dhe do të shohin që diferenca nga qyteti tashmë errësek në qytetin Leskovik është afruar për shkak të ndjesë të investimit për rrugën. Së pari, është një investim shumë cilësor dhe ka ndikuar ndjeshëm në rritjen e numrit të turistëve. Së dyti, lidhur me elementin bujqësi, ne nuk mund të themi se kemi rënie të pikëpamjes se sa ka ndikuar kjo në cilësinë e banorëve, por kemi një tregues shumë të dukshëm që është ngritja e inkubatorit të parë në Shqipëri nga gratë leskovishare, që nuk bëjnë gjë tjetër veçse paketojnë, mbledhin, kompostojnë të gjithë frutat e zonës, duke i tregtuar më pas me standarde europiane. Dhe mendoj që ky është një tregues shumë i dukshëm përsa i përket elementit bujqësi. Elementi i arsimit, shkolla në Leskovik trajtohet si shkollë e bashkuar, por nga ana tjetër, investimi që është aty është, pra, nxënësit aty trajtohen barabartë, mund të them si një nxënës në qytet apo në kryeqytet, sepse shkolla ka standarde europiane tashmë dhe trajtohet ose bashkëngjitet ashtu aty një palestër apo një terren sportiv shumë cilësor për fëmijët e qytetit të Leskovikut. Të gjithë këta detaje mendoj se tregojnë atë çfarë unë nënvizua. Këtë desha të shtoj. Faleminderit.

### **Xhelal Mziu:**

Meqënëse kemi të bëjmë me ju, çfarë pozicioni keni aty nënkryetar? Përse nuk ka ardhur kryetari? Sepse është më kompetent.

### **Arbjan Mazniku:**

Është për një, ka një program shëndetësor, ka shkruar dhe ka një program shëndetësor dhe do vijë në mbledhjen që do bëjmë.

### **Xhelal Mziu:**

Uroj që të mos jetë vetëm shëndetësor. Së dyti, më tha Filo që bujqësia është në progres. I sheh ndonjëherë lajmet kur fermerët e Korçës dhe sidomos të Devollit ju ngelen produktet bujqësore aty duke i hedhur në kanal? Apo nuk i sheh? Të shqetësojnë këto apo nuk të shqetësojnë? Dhe nuk më tha si ka mundësi që të gjashtë bashkitë e këtij qarku kanë rritur në mënyrë progresive fondin e pagave dhe unë po ja them sipas deri në vitin 2024, aq sa e ka emetuar dhe Ministria e Financave dhe thuhet që Bashkia e Korçës e ka rritur fondin e pagave tre herë më shumë sesa 11 vite më parë ose 10 vite se është bërë 2024 me 2015. Po Gradesi e ka rritur vetëm dy herë më shumë. Pra, që do të thotë që është tregu i çikë më nikoçir. Devolli dy herë më shumë është pak më mirë. Erseka tre herë më shumë fondin e pagave, ndërsa Maliqi, si esnaf i vjetër që është, katër herë më shumë e

ka rritur fondin e pagave, në vend që të shkojnë për taksa, taksat shkojnë për rrugë, për shërbimet ndaj qytetarëve, katërfish. Është rritur deri në vitin 2024 fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore në Bashkinë e Maliqit. Kjo është fytyra që keni treguar në drejtime e këtyre bashkive dhe jo nga ju, por nga pamundësia ekonomike dhe përdorimi i bashkive si një shtojcë elektorale e qeverisë. Dhe pyetja ime është: meqënëse fondi i pagave është rritur katër herë më shumë sesa 10 vite më parë, a janë rritur investimet katër herë më shumë? A janë rritur shërbimet katër herë më shumë? S'ka se si rriten, sepse vetëm investimet janë ulur dy herë më pak, nga 36.5 në 18%. Mund të më bëni një koment pse keni rritur shpenzimet për pagët tre dhe katër herë më shumë sesa 10 vite më parë?

**Sotiraq Filo:**

Mund të them diçka? Tani unë padyshim që i njoh edhe shqetësimet edhe problematikat që kanë fermerët e Bashkisë së Korçës edhe më gjerë të qarkut të Korçës, sidomos ato që lidhen me dëmtimet herë pas here të kulturave bujqësore për shkak të fenomeneve atmosferike apo edhe vështirësi në momente të caktuara të shitjes së produkteve bujqësore. Por, me thënë të drejtën, nuk e kuptova këtë korrelacionin ndërmjet reformës administrative dhe si reforma administrative e ka përkeqësuar situatën e shitjes të produkteve bujqësore. Nuk e mora vesh këtë. Ndërkohë, po s'kam për ta marrë vesh se nuk ke çfarë të më shpjegosh tani. Po ti s'ke çfarë të më shpjegosh tani. Do më tregosh mua tani? Po të lutem tani. Po mirë, ja kur të ikim, kur të ikim ne.

**Arbjan Mazniku:**

Zoti Mziu, ju lutem.

**Sotiraq Filo:**

Kur të ikim ne, ja u shpjegova këtyre kolegëve deputetë se si lidhet reforma me përkeqësimin e shitjes të produkteve bujqësore. Ndërkohë, ajo që thashë dhe e them përsëri, impakti i reformës në infrastrukturën bujqësore që lidhet drejtpërsëdrejti me sasinë, me cilësinë e prodhimit bujqësor ka qenë jashtëzakonisht i madh. Sot ka toka të kulluara, farë kanaleve kulluese që kanë, që mbillen, se më përpara edhe nuk i mbillnin dhe tani që i mbillin, jo vetëm i mbillin, por kanë edhe produktivitet më të lartë. Dhe këtë ma thonë fermerët. Shkoni, pyesni fermerët e Ravonikut. Për shembull, se atje kam fiksuar që ma kanë thënë tani që na i bëtë juve këto, na kulluan tokat, po i mbjellim edhe po marrim rendiment. Shkoni, pyesni fermerët e Dvoranit dhe të gjithë bashkisë për gjendjen e rrugëve të parcelave që lidhet edhe me shkuarjen për t'i bërë shërbime, po dhe për të tërhequr prodhimin bujqësor. Me rrugët me gropa do dilte prodhimi 50% apo më tepër i dëmtuar. Tani del ashtu siç edhe vilet. Shkoni, pyesni për situatën me vaditjen, krahasuar me çfarë kemi gjetur për infrastrukturën bujqësore që fola, e mbroj edhe.

**Arbjan Mazniku:**

Ju lutem, ju lutem.

**Sotiraq Filo:**

Unë, unë, unë dëgjova. Pyetjet që desha, unë që bëre pyetjet, zotëri Mziu.

**Xhelal Mziu:**

Domethënë kemi rritur vadijen, kemi rritur kullimin, por nuk dimë çka bujqësia. Ja shife, një kryetar bashkie në një minutë, në një minutë thotë dy gjëra të kundërta.

**Luçiano Boçi:**

Po s'e lamë këtu deputetin.

**Xhelal Mziu:**

Bujqësia, bujqësia nuk kemi lidhje me bujqësinë, thotë. Ndërkohë, thotë, kemi, kemi, kemi përmirësuar kullimin, kemi përmirësuar vadijen. Jo, po ai thashë punë kemi ne me bujqësinë. Ja, ai thashë punë kemi ne me bujqësinë. Ndërkohë, thotë, kemi rritur vadijen që nuk, nuk, nuk mbjellëshin tokat. Kemi rritur kullimin. Ju lutem, një person që ka ndryshe flet, po ju tani dhe pas 10 sekondash, vetëm filo e din.

**Arbjan Mazniku:**

Zoti Mziu, ju lutem, zotëri Mziu.

**Xhelal Mziu:**

Vetëm filo e din.

**Arbjan Mazniku:**

Zoti Mziu.

**Xhelal Mziu:**

A mund të më thoni pse ke trefishuar fondin e pagave në 10 vite? Ju lutem, po jo, jo, jo, po s'më dëgjo. Të më kthej përgjigjen.

**Arbjan Mazniku:**

Dëgjo, ju them sërish, në pyetjen dhe parashtimin tuaj keni thënë një seri numrash të paqena, të pasakta, të gabuara, të pafund. Një sekondë.

**Xhelal Mziu:**

Vetëm ti je gënjeshtër. Unë jo.

**Arbjan Mazniku:**

Dhe tani, dhe tani, dhe unë nuk kam ndërhyrë. Të lutem, mos më thuaj, mos më fol kështu se s'të kam folur, sepse nuk të kam folur kurrë.

**Xhelal Mziu:**

Nuk ndërhyj kur tha që nuk ka varësi me bujqësinë. Nuk. Dhe pastaj tha: "Unë kam rritur sipërfaqen e vadisë. Unë kam përmirësuar kullimin.

**Arbjan Mazniku:**

Nuk kam ndërhyrë dhe nuk do t'i ndërhyjë askujt." Dhe kullimi nuk janë asesorët e bujqësisë. Bëhet pyetjen tuaj, zotëri Mziu, bëhet pyetjen tuaj.

**Xhelal Mziu:**

Bëri dhe ironikun. Ndërkohë, harroj sa që ka memorien, harroj pastaj të përdori...

**Arbjan Mazniku:**

Për sasinë e memories dhe për sasinë e memories dhe për inteligjencën. Nuk keni fare kapacitet për të bërë gjykim për askënd.

**Xhelal Mziu:**

Unë po merrem me shpалosjen e platformës së atij. Po nuk keni për as shpалosjen e platformës së atij. Se keni ju tagërza për këtë punë. Po them përse ka trefishuar fondin e pagave në 10 vite? Pse ka ndryshuar?

**Arbjan Mazniku:**

Zoti Mziu, mbaruat pyetjen tuaj. Se ka përgjithësuar investimet. Pyetjen tuaj tani lëni njerëzit në respekt të faktit që janë zgjedhur këtu. Aty ka kryetarë bashkish që kanë marrë vota më shumë se ty. Kanë marrë vota më shumë se ty.

**Xhelal Mziu:**

Shihni punë tjetër.

**Arbjan Mazniku:**

Jo, jo, kanë marrë vota më shumë se ty. Janë përfaqësues të qytetarëve shqiptarë dhe kanë dhe i kemi thirrur këto. I kemi hequr nga puna që ju flasim. Mbaruat pyetjen tuaj. Mbaruat pyetjen tuaj.

**Xhelal Mziu:**

S'e kam mbaruar unë. Do më kthej përgjigjen.

**Arbjan Mazniku:**

Mbaruat pyetjen tuaj. Do lëni kryetarët përgjigjen. Do më kthej përgjigjen. Etika, etika e komunikimit është elementi që shpallu që punë kemi ne me bujqësinë. Aty ne se shpallim element thelbësor. Element thelbësor në qytetari. Zoti Mziu,

**Xhelal Mziu:**

Kush e bën kullimin?

**Arbjan Mazniku:**

Zoti Mziu, kush e bën? Zoti Mziu, e kupton?

**Xhelal Mziu:**

Vaditjen. Etika e komunikimit. Kemi rritur vaditjen, kemi rritur kullimin.

**Gëzim Topçiu:**

Zoti bashkëkryetar, mund të shpjegojë situatën pasi edhe shifrat.

**Xhelal Mziu:**

Jo, jo, më thotë zoti Filo pse bashkia ka shpenzuar tre herë më shumë fond për administratën në këto 10 vite. Zoti shpenzimi të administratës. O, o, Gëzim! Ndese ke dalë në pension ti tani, se nuk je më kryetar bashkie. Ke mbaruar deri në këtë se tash të mbyllur mandati, se ke bërë nja 30 vite. Ke vajtur aty. Seriozitetit, të them të drejtën, jepi drejtim tashi. Mos i mos i qytetarët. Edhe njëherë të pyet aty unë. Po pyes zotin Filo. Po jo se the për bashkinë e Maliqit. Edhe njëherë. Po e ngatërrove se u përgjigjen njerëzit. Nuk mban mend. Tjetër. Po the për mua. Më kthe zoti Filo.

**Gëzim Topçiu:**

Mund të sqaroj një moment se është shumë i rëndësishëm zoti Mazdiku në lidhje.

**Luçiano Boçi:**

Ora, ti mund të thuash pse u përmyt. Maliqi, fushat e Maliqit, pse u përmyten? Këtë mund ta thuash ti. Po sa të mbarojë Filo, të mbarojë Filo, të mbarojë Filo. Harroj zoti Filo njëherë për përgjigjen për rritjen e shpenzimeve për administratën që është trefishuar.

**Sotiraq Filo:**

Edhe, edhe diçka. Nuk thashë që bashkia nuk ka lidhje me bujqësinë. Thashë që thashë që pastaj ore tani më lër të them çfarë thashë tani. Po kthehem. Po kthehem. O, po jo, kemi ne me bujqësinë.

**Arbjan Mazniku:**

Zoti Mziu, ju lutem, ju lutem, lejoni njerëzit, lejoni njerëzit të mbarojnë pyetjen e tuaj.

**Sotiraq Filo:**

Atëherë, atëherë nuk thashë që bashkia nuk ka lidhje me bujqësinë, por thashë nuk e kuptova korrelacionin që juve bëtë ndërmjet reformës administrative territoriale dhe përkeqësimit apo problematikës në shitjen e një produkti të caktuar bujqësor. Këtë

njerëzit, jo reforma, reforma. Si mund të... Të lutem, duhet ta shpjegoni tani. Më lini ta them unë, pastaj më komentoni. Atëherë, atëherë tani e urrej.

**Arbjan Mazniku:**

Si është kjo? Si mund të vijmë këtu në parlament dhe thotë çfarë duhet të thotë e çfarë s'duhet të thotë? Ore, si mund të gjykojmë neve çfarë do të thotë e çfarë s'do të thotë njeriu?

**Luçiano Boçi:**

Në atë pjesën që kur dëgjojmë një kryetar bashkie që s'ka përgjegjësi për bujqësinë në territorin atij, o sigurisht se kemi qenë, o miq, se kemi qenë, ore, se kemi qenë këtu gjithë ditën. Se do reagoj.

**Arbjan Mazniku:**

Keni thënë, keni thënë, keni thënë të gjithë, të gjithë njerëzit. Keni thënë broçkulla sa keni dashur. Kanë folur kryetarët çfarë kanë dashur. Lejeni më njerëzit të japin mendimin e tyre.

**Luçiano Boçi:**

Kush e ofendoj? Kush e ofendoj?

**Arbjan Mazniku:**

Po tani, si për komisionin timor, as komisionet timor nuk pyeten ashtu.

**Luçiano Boçi:**

Ja do ta sqaroj edhe këtë se e sqarova që në fillim. Tani, zoti Penavinji, po nuk kanë ardhur, nuk kanë ardhur në komisionet timor. E sqaruam që në fillim. Është dëgjimor, por ka një gjë: dëgjimor, jo unë pyes për çështjet e reformës. Ti më përgjigjesh si do ti, sepse ne duam mendim nga kryetarët e bashkive. Edhe njëherë, këto i kemi marrë këtu për burra që kanë përvojë në menaxhimin e territorit. Të lutem, po të lutem ta përfundoj. Po ta përfundoj unë. Ta përfundoj unë. Ta përfundoj unë se po flas unë. Po, po flas unë në këtë rast. Dhe në momentin që deputeti ndërhyr për të orientuar një përgjigje që na shërben, mua më duket më se logjike. Jo, nuk është synimi që deputeti do të nxjerri keq kryetarin e bashkisë këtu. Na jep një përgjigje që edhe ne të orientohemi. Unë nuk jam specialist bujqësie, nuk jam marrë me bujqësinë dhe nuk e di korrelacionin e fortë që pushteti vendor ka me bujqësinë. Dhe në këtë rast, ju që jeni këtu, që aplikoni, që keni synime, o zoti Penavinji, se po flas me të, ne duam një përgjigje. Pra, mos u kapni, mos u kompleksoni nga pyetjet që bëhen, ndoshta dhe nga përgjigjet jo të duhura. Ne duam përgjigjet e duhura. Kaq.

**Arbjan Mazniku:**

Të lutem, tani një sekondë, tani më fal, si bashkëkryetar i komisionit, mundeni ta menaxhoni dëgjesën që ne ju dëgjojmë? Dëgjojmë gjysmë ore diskutime, parashtrësia, edhe ndonjë pyetje nëpër të, dhe kur vjen puna të flasim, na ndërprisni të gjithë. Mundemi? Kur flasim, mos na ndërprisni. Është minimumi i etikës së komunikimit. Flet njeri, dëgjojnë të tjerët. Flet tjetri, dëgjojmë neve. Kaq po kërkoj tani, edhe njëherë, mos vini në gojën time, se është e turpshme, shumë e rëndë edhe e turpshme, të më vini referenca që nuk i kam thënë. Nuk thashë në asnjë moment që bashkia nuk ka lidhje me bujqësinë, por thashë, por thashë, dhe po e përsëris për herë të tretë, edhe hapni dhe kasetat, cili është argumenti që me reformën u përkeqësua shitja e produkteve bujqësore të fermerëve? Se ky ishte argumenti: u bë reforma dhe u përkeqësua, ngelen produktet në ferma. Çfarë lidhje kishte reforma me përkeqësimin? Minimalisht mund të thuhet nuk e keni përmirësuar situatën e shitjes. Po cili element i reformës e përkeqësoi? A jap, zoti Filo, ndonjë përgjigje? Jo, po ja të mbaroj, të lutem, se isha duke folur. Po se ishte pyetje. Pra, po isha duke folur dhe këtë thashë. Tani mos më vini në gojë, edhe deputeti, dhe ju si bashkëkryetar, që ju thatë, domethënë unë thashë që bashkisë kanë lidhje me bujqësinë. Tani më vjen keq për këtë gjë dhe po e përsërit: impakti në infrastrukturën bujqësore ka qenë i jashtëzakonshëm, me efekt të matshëm, të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe në sasinë e produkteve bujqësore dhe blektorale të bashkisë. Shitjet, po, në momente të caktuara mund të kenë patur problematika, por jo për shkak të reformës. Pra, nuk është se reforma e ka përkeqësuar këtë element. Në lidhje me fondin e pagave, nuk është e vërtetë ajo referenca: është trefishuar fondi, është trefishuar në raport me kë, me bashkinë e vogël që administronte vetëm qytetin. Pra, bashkia pas 2015-ës administron qytetin dhe 64 fshatra. Një. E dyta, në 2016-ën kemi marrë një grup të madh funksionesh që ka në numra nga mbrapa: edukatorët, personelin, roje shkolle, pastruese. Nuk i kemi patur tani. Po, mirë, patjetër, zjarrfikëse, menaxhimi i rrugëve rurale, shërbimi pyjor, ujitje, kullimin. Pra, janë të gjitha funksione që kërkojnë staf që ka qenë nëpër drejtori të ndryshme. Patjetër që do rritet fondi i pagave dhe fondi i pagave, se e kam bërë shumë herë këtë diskutim edhe në këshillin e bashkisë. Fondi i pagave përcaktohet nga dy elementë: numri i punonjësve dhe niveli i pagave. Niveli i pagave është i rregulluar me VKM, me vendim qeverie, sipas kategorive të bashkive. Nuk i rrit dot kryetari i bashkisë nivelin e pagave ta çojë sa të dojë. Është e përcaktuar në VKM. Një bashki me këtë numër popullsie i cakton, i takon kjo kategori, ka këtë nivel pagash për çdo pozicion: nga kryetari, drejtori, përgjegjësi, specialisti, staf mbështetës. Numri i punonjësve nuk ka numër të fryrë punonjësish dhe po ju jap edhe një argument për këtë: numri i punonjësve që unë kam në organikën, në plan, në strukturën e miratuar është 1370 e ca, ndërkohë numri faktik është 1170, të themi, tasho. Po tani po të doja unë t'i bija dhe këtë strukturën me 1300, e kam të miratuar në këshill të bashkisë. Po të doja unë ta abuzoja dhe të merrja njerëz në punë për të bërë nderë dhe historira të këtilla, e kisha plotësuar, kisha shkuar në 1370 e ca. Ja ta shoh fiks që mos bëj ndonjë gabim. Atëherë të flasim se si bëhet struktura. Të miratuar e kam 1342, faktik e kam 1117. Po të doja mund të merrja minimalisht 1342, por i kam të planifikuar dhe i shoh sipas situatës dhe angazhojmë ato kapacitete njerëzore që na duhen. Kjo është historia e fondit të pagave. Shumë faleminderit.

**Xhelal Mziu:**

Për ta mbyllur dy minuta. Ëh, zoti Filo, spajën na dhe leksion, po prapësepsi merren punonjësit. Unë, nëse ke qenë i vëmendshëm që në kryetarës, thashë është kompetencë e këshillit bashkiak dhe është pa limit. Dhe në këndvështrimin tim duhet të ketë tavan. Nuk mundet, po themi, se nuk ka këshill bashkiak që bën paoreksin e kryetarit të bashkisë. Nuk mundet që një bashki të bëjë vende pune pafundësisht. Dhe sot, në të gjitha bashkitë pothuajse, ke persona që s'kanë një vend pune, nuk kanë një kompjuter, nuk kanë një vegël pune. Dhe unë kërkova që të ketë ndryshim dhe s'po u akuzoj ju personalisht, po është krijuar frymë, frymë për të patur persona dhe për të dërguar fondin e pagave. Dhe jo më kot, bashkia juaj tre herë e ka rritur, Maliqi katër herë, por disa kolegë të tjerë e kanë rritur vetëm dy herë. Dhe më the pak më përpara që si ka mundësinë pasi kam shkruajtur unë nga Leskoviku, apo nga Voskopoja, apo nga Drenova, dhe unë kohë reale më vjen një mesazh tani nga një person anonim, se e kam transparent atë numrin e telefonit në WhatsApp. Po deshe, më ka ardhur në orën 18:00. Ja çfarë thotë: "Zoti Mziu, jam një banor i fshatit Gjergjevicë, i komunës Lekas. Asnjë investim, as nga komuna, e ka fjalën për njësinë ish-komunën dhe njësinë administrative, as nga bashkia Korçë. Zoti Filo thotë: 'Gënjen se infrastruktura është si mos më keq.' Po deshe, hajde dhe shife, shife këtë SMS për të treguar se s'më..." Për të treguar se s'më... nuk është vetëm ky SMS-oja, po për të treguar shqetësimin që ty, pasi kanë ardhur shqetësime nga Voskopoja, nga Drenova, nga Pojani, nga Leskoviku, paskan ardhur ty. Po ti, në qoftë se s'del asnjëherë atje për t'i takuar dhe as nuk i pret këzyra, s'ka se si ta marrësh vesh. Kurse unë, në kohë reale, në kohë reale, vjen një banor i juaj dhe ndërkohë ankohet për ty.

### **Sotiraq Filo:**

Po, atëherë u përmend nga ana juaj, u përmendën specifikisht dy fshatra në dy njësi: Voskopoja dhe Drenova. Gjergjevicë i takon ish-komunës të Lekasit. Nuk është, nuk është... po të lutem, pra tani, edhe njëherë, po tani, të lutem, kur fola unë, ju referova fjalës të mëparshme ku ju përmendët Voskopojeën dhe Drenovën dhe të thashë: "Në Voskopoje është bërë pothuaj çdo gjë e re." Domethënë, fshati që ka marrë më tepër investime në bashkinë e Korçës dhe i takon për historinë atë, kulturën dhe çfarë përfaqëson, është Voskopoja. Është bërë çdo gjë e re. Patjetër, nuk thashë në ndonjë moment, nuk... ëh, nuk thashë në ndonjë moment, nuk më pyetët dhe nuk thashë që çdo problematikë në të gjitha fshatrat e njësisë e bashkisë së Korçës është e zgjidhur. Fshatrat e bashkisë së Korçës kanë nevojë akoma për shumë investime. Ama, falë reformës, janë bërë shumë punë që, po të ishte ajo ndarja e mëparshme, nuk do ishin bërë. Po ka nevojë, sa të duash, patjetër, ta them vetë unë. Dhe Gjergjevicën, po, ka nevojë. Është komuna më e largët që, njësia administrative më e largët që ne kemi dhe ka nevojë patjetër për investime. Nuk e kundërshtoj. Kundërshtova Drenovën edhe Voskopojeën, se atyre ju referuat më parë. Ka një ndërhyrje.

### **Arbjan Mazniku:**

Zoti Topçiu.

### **Luçiano Boçi:**

Jo, një ndërhyrje, sepse patëm një kështu debat në raport me prononcimin tuaj. Për të qenë korrekt, kur Xhelali të solli referimin e produkteve bujqësore, tha që s'ka lidhje bashkia apo me shitjen dhe... dhe se ka thënë... ja një minutë, ta çoj deri në fund se sikur do ndërhyesh dhe e parashtruat që nuk... dhe e parashtruat që nuk... dhe e parashtruat që nuk ka korrelacion midis reformës territoriale dhe çështjes së zhvillimit bujqësor, apo jo? Jo, jo, po zhvillimi bujqësor përfshin edhe shitjen tani. Po nuk tha këtë. Po unë them shitjen, ju kundërshtoni. Unë them zhvillimin, ju kundërshtoni. Diçka, atëherë, atëherë ku është korrelacioni, zoti Filo? Korrelacioni është tek ndikimi që pushteti lokal me kompetencat e tij, me autoritetin e tij, duhet të ushtrojë me qëllim që zinxhiri i produktit bujqësor të shkojë deri në fund, se ka një shqetësim që nuk e ndjejmë vetëm sot. Është ndër vite që i hidhen produktet, sepse ajo zonë është shumë punëtore dhe toka është pjellore. Po, këto janë dy elementët kryesorë. Nuk po të heq fjalën që është merita juaj se duket sikur po kundërshtoj, por thashë dy elementët më kryesorë. Dhe ajo që ka munguar përgjatë gjithë këtyre viteve është fundi i zinxhirit të këtij prodhimi. Kush është? Përpunimi agro-ushqimor. Është iniciativë e fermerëve, por pushteti vendor duhet të lozë rolin e tij zhvillimor ekonomik. Prandaj, dhe për shembull, meqënëse jemi te Korça, në fakt kam dashur ta parashtroj edhe në takimet e tjera. Ajo që më ka shqetësuar, sidomos për bashkitë që kanë zonë rurale dhe kanë bujqësi që edhe mund të zhvillohet, nuk kanë një hartë produkteve bujqësore të orientuar. Mund ta bëjnë dhe qendra. Unë e quaj domosdoshme, sepse harta e produkteve bujqësore siguron edhe tregun. Nuk ka mbiprodhim të tepërt dhe të dalë dhe të hidhet, se nuk orientohet fermeri. Ja pra ku bashkia mund ta orientojë, ose zyrat e orientimit të biznesit, në këtë rast. Prandaj, mos e kisha për atë që ka lidhje, ka lidhje totale, por mos u keqkuptoni nga segmentet e fjalës apo të fjalive. Dhe zoti Mziu këtu e kishte. Po më patjetër, se për këtë...

### **Sotiraq Filo:**

Atëherë, edhe njëherë, po e risa këtësoj për të disatën herë. Thashë që reforma administrative territoriale nuk ka prodhuar efekte negative në shitjen e produkteve bujqësore. Pra, nuk është se për shkak të reformës u krijuan problematika shtesë. Ekziston si problem? Po, mund të bënte... mund të... ja, ja, ja të lutem, ja të lutem, se jo, jo të lutem, jo, jo të lutem, dhe po e vazhdoj. Atëherë, mund, mund të bëjë... po manisë, manisë pastaj... ëh, mund të bënte më tepër, mbase mund të bënte më tepër. Ka bërë pozitivisht? Po. Dhe po ju jap një shembull: produkti kryesor, apo njëri nga produktet më kryesore, më tipiku që na identifikon ne si bashki, është molla. Dhe potencialisht, kur ka momente superprodhimi, përtej atyre që shiten drejtpërsëdrejti si mollë tavoline, sasia e mollës të cilësisë të dytë, të tretë, mund të ngelet dhe mund të hidhet. Dhe falë iniciativës të bashkisë, kemi mundësuar çeljen e një linje të përpunimit të mollës. Bashkia i ka vënë në dispozicion biznesit një ambient me qera, biznesi ka investuar tek linja dhe ju ka zgjidhur një problematikë fermerëve për mollën. Po t'i pyesësh sot fermerët, mollën e tretë që e hidh në kanal, ai ja u ble me 120 lekë të vjetra kilogramin. Ja një shembull se si reforma, se po të ishte bashki urbane para reformës, mbase nuk do ta kishim këtë ndjeshmëri për një problematikë rurale. Duke qenë bashki e madhe, e kemi patur këtë ndjeshmëri dhe është bërë i mundur realizimi i këtij investimi për produktin më tipik që ne kemi. Tani jemi në proces bashkëpunimi me Fondin Shqiptar të Zhvillimit për të bërë një

projekt të madh pikërisht për produktin e mollës. Ideja është që të ndërtohet një linjë për seleksionimin dhe paketimin e mollës, që molla të mos shitet nga fermerët e pastandardizuar në seleksionim dhe në paketim, po t'i kalojë këto procese dhe të marrë vlerë të shtuar, dhe të tentohet nëpërmjet kësaj linje që të krijohet edhe mundësia e bashkëpunimit të fermerëve në momentin e shitjes. Pra, ta sjellim, ta prodhojmë produktin individualisht, ta sjellin tek linja, ta selekcionojnë, ta paketojnë dhe po të duan ta marrin përsëri mbrapa, ta shesin individualisht, po të duan ta lenë aty, ta grupojnë me prodhimin e fermerëve të tjerë, të kapin sasi ekonomi shkalle dhe potencialisht tregje më të mira me të ardhura më të mira. Këto janë dy nga projektet e bashkisë, meqënëse u përmend çfarë ka bërë bashkia. Mund të bëhet më tepër? Po. Po, minimalisht dhe po këmbëngul. Nuk ka prodhuar reforma efekt negativ. Pozitiv ka prodhuar këto: janë shumë, janë pak, hajde t'i diskutojmë. Negativ? Jo, në asnjë... dhe ju sfidoj prapë, më thoni në çfarë momenti ish-komunat i shisnin, i ndihmonin fermerët t'i shisnin më lehtësisht produktet e tyre sesa e bën bashkia e madhe? Jo, po ma dhatë këtë argument, do të tërhiqem, do të them...

**Arbjan Mazniku:**

Faleminderit, zoti Filo. Gabim. Zoti Topçiu.

**Sotiraq Filo:**

Dy momente. Duhet të flas... Ju prapë puna keni thirrur t'i japim ndonjë mendje. Edhe na thërrisni dhe thoni pse na jepni mendje. E pikëllu. Nuk është për të luajtur. Çfarë ka bërë?

**Arbjan Mazniku:**

Zoti Topçiu.

**Gëzim Topçiu:**

Nuk është që më futet kështu makro gjithë Shqipëria, tërhiqem. Unë flas për Korçën. Nuk ka nevojë. Dy momente. Dua të diskutoj në lidhje... momenti i parë ka të bëjë me fondin e pagave dhe unë ndaj e thashë, nuk e di kush është referenca që është kapur zoti Mziu. Maliqi, për të njëjtën gjë kisha pse u përmbytën fushat e... Ja ta jap edhe atë, po bëhet fjalë edhe për këtë të pagave tani. Ndaloje ti, për pagat e kisha për tjetrën. Po, po, po, jo. E dyta, e dyta, se nuk thashë nuk është investuar në bujqësi dhe po të jap vetëm pesë projektet investuara në fushën e Maliqit, siç është stacioni i pompimit Pojan, ku kemi bërë një stacion të ri pompimi për të ujitur rreth 500 hektarë tokë, rehabilitimi i kaskadës së Zëmlakut, i cili është bërë nga Ministria e Bujqësisë, rehabilitimi i kaskadës së Vashmisë po ashtu, ushqyesi i rezervuar Vërçum-Potgori 15 km dhe kanalet e ujitjes në njësinë e Pirkut, që janë investime direkt në bujqësi. Përmbytjet kanë ndodhur në fushën e Maliqit. Unë e citova pak më parë, po e përsëris. Jo vetëm pse në tre ditë ranë rreshje sa për gjashtë muaj, dhe kjo është e verifikueshme nga të dhënat sizmologjike, të dhëna nga institucionet përkatëse, por ka pësuar çarje edhe lumi Dunavec për efekt të prurjeve dhe lumi Devoll, dhe ato kanë mbytur fushën e Maliqit në zona torfike ku ka rënë niveli i tokës rreth dy metra e gjysmë, dhe kjo është e verifikueshme nga specialistët, nga Drejtoria e Bujqësisë, nga Ministria e Bujqësisë. Nuk dua të heq asnjë përgjegjësi tonën personale,

por kanalet kulluese që ne menaxhojmë janë të gjitha të pastruara dhe pastrohen rast pas rasti, falë edhe flotës së ekskavatorëve që bashkia ka katër në punë pa ndërprerje.

### **Luçiano Boçi:**

Po, faleminderit. A keni ju pyetje? Po, po, po. Ku? Po. Ah, okej.

### **Ermal Elezi:**

Ëh, tek kjo e fundit duhet të ndalesha. Unë mendoj që kjo tematika e bujqësisë na bashkon të gjithëve dhe është shqetësim. Fermerët kanë nevojë për mbështetje. Mendoj që bashkitë, pas një diskutimi, duhet të bëjnë shumë më tepër për t'i qenë më pranë fermerëve, pasi shpeshherë nuk janë në gjendje, siç u përmend këtu, qoftë që të orientohen drejt tregut, po qoftë për të pasur një mbështetje edhe me dije. Dhe duke qenë se ka struktura dhe bashkitë, unë mendoj që pjesë e diskutimit tonë në kompetenca dhe në anën administrative, përveç atyre sugjerimeve që u dhanë përse i përket infrastrukturës bujqësore, mendoj që duhet të jetë dhe një rol që përfshijnë ato agropikat ose ekstensionin ose konsultimin bujqësor. Tani, dua të bëj një krahasim të thjeshtë përse i përket temës që dua të diskutoj. Unë këtu kam dy grafikë. Kam një grafik i bashkive në bazë të vetëfinancimit nga të ardhurat e veta dhe kam një grafik në lidhje me shpenzimin për banorë. Është tregues i qartë që madhësia është element përcaktues në të dy grafikët. Vetëfinancimi fillon nga Bashkia e Korçës, që e ka 40%, po gradecja e ka 31.3%, Devolli e ka 24%, pastaj Maliqi me kolonjën 14% dhe Pushtetësja ka më pak se 4%. Nga ana tjetër, përse i përket shpenzimeve si për personelin dhe për banorët, unë si për shpenzimet, si për personelin dhe kapitalin për banor, sepse kështu është e vërtetë e matur, po të shohim ndodh e kundërta. Sa më e vogël është bashkia, aq më shumë fillon kushton. Korça ka shpenzimet më të ulëta për banor, po gradecja, pastaj është Maliqi, pastaj Devolli, pastaj kolonja dhe Pushtetësia, e keni me grafik, ka shpenzimet më të larta për banor, që do të thotë edhe teoria e ekualizimit që këto bashkitë që janë më të varfra marrin dhe më shumë financim, është e provuar dhe këtu qartë. Përballë këtij argumenti, unë kam një pyetje fare të thjeshtë: Tabu nuk është bashkimi, por nëse bashkimi funksionon, duhet diskutuar. Se unë nuk i besoj vetëm eficiencës ekonomike. Ka diskutuar dhe bashkëkryetari, ka dhe formula të tjera. Këtu u përmend nga ana juaj pjesa e rolit të qarkut, por duhet të identifikohet më qartë, apo një rajoni. Nga ana tjetër, ka ligji aktual, dhe te kjo duhet të dal më specifikisht, ka të parashikuar në nenin 14 shumë të saktë si mund të instaurohet funksioni i bashkëpunimit ndërbashkiak. Dhe pyetja ime është: Keni përvoja të tilla? Në cilat fusha dhe në cilat fusha do të ishte e dobishme që të kishit përvoja të tilla? Dhe sidomos në aspektin dhe të kapacitetit për fondet ndërkombëtare, do të doja të dija më tepër nga ju. Sepse në rast se kjo, me sa kuptoj juve, ju duket si e vështirë, kostot e koordinimit dhe e keni provuar kur kanë qenë njësitë e ndara në komuna, se çfarë do të thoshte dhe nuk bëhej dot një projekt i përbashkët, duhet gjetur një mekanizëm zgjidhje, sepse qartazi aty ku bashkohen funksionon. Nëse nuk është ky amalgamimi tipik ku disa e quajnë shkrije, po për mua është bashkim, atëherë këto modelet e tjera pse nuk na funksionojnë? Sepse unë vetë di ndoshta një rast në Korçë, nuk ushtrohet në mënyrë vullnetare, sepse dy ose më shumë bashki duhet të bëhen bashkë të firmosin një

marrëveshje dhe të ulen të ushtrojnë kompetencat e përbashkëta në fushën e mbetjeve, në fushën e pastrimit të qyteteve apo çfarëdolloj gjëje që të jetë. Se nëse nuk na funksionon koordinimi vullnetar, kostot janë kostot. Dhe e vërteta është që paguajnë të gjithë si tatimpagues, por nuk është se paguhen të gjithë aty në vend dhe qarkullojnë aty. Paguhen dhe në Tiranë edhe shkojnë atje. Paguhen dhe në Elbasan dhe shkojnë atje, ku inefiçenca është më e lartë. Dhe ne duhet të na dhimbset edhe pjesa e tatimpaguesve dhe kudo që vijmë. Pra, për funksionet ndërbashkiake dhe sugjerimin prapë për qark, unë e dua me një propozim konkret nëse ka, sepse këto mund të marrim parasysht si pjesë të platformës. Faleminderit.

### **Arbjan Mazniku:**

Zoti Filo.

### **Gëzim Topçiu:**

Mirë, përsa i takon bashkëpunimit ndërmjet bashkive, ne kemi një shembull konkret edhe shumë të mirë të bashkëpunimit ndërbashkiak ndërmjet gjithë bashkive të qarkut të Korçës, që është menaxhimi i mbetjeve. Konkretisht, është ndërtuar me mbështetje të qeverisë gjermane të KFV-së një landfill sanitar në afërsitë të Maliqit, ku depozitohen mbetjet e ngurta të të gjithë bashkive të qarkut të Korçës. Dhe ky landfill menaxhohet nga një shoqëri aksionere, ku aksionerë janë të gjithë bashkitë e qarkut, të gjashta bashkitë e qarkut. Dhe është një model i cili funksionon dhe me çfarë na është thënë, është mbase modeli më i mirë në Shqipëri i menaxhimit të një landfili. Tani, përsa i takon bashkëpunimit ndërmjet bashkive, unë mendoj që janë tre raste kur ky bashkëpunim është i domosdoshëm dhe me përfitim. Një rast është kur bashkitë kanë resurse ekonomike kryesisht, të cilat individualisht arrijnë deri në një nivel të caktuar, po ndërkohë po të kombinohen, mund ta shumëfishojnë efektin e tyre. Konkretisht, turizmi. Çdo bashki e qarkut të Korçës ka potencialin e saj turistik. Korça ka pjesën e trashëgimisë, muzeumeve, Jetës së Natës, Voskopojës, Dardhës. Prespa ka liqenin, po gradecia ka liqenin e Ohrit. Çdo bashki ka potencialin e saj. Ama, në rast se kombinohen të gjitha bashkë, pastaj efekti është i jashtëzakonshëm. Domethënë, potenciali apo çfarë ofron nga ana turistike qarku i Korçës, i kombinuar me potencialet e të gjitha bashkive, ajo është një diçka e jashtëzakonshme. Dhe në këtë rast, bashkëpunimi është me përfitim. Rasti i dytë është kur ndajmë të njëjtin resurs ekonomik, që mund të jetë, për shembull, ne me Maliqin ndajmë fushën e Korçës. Është një resurs ekonomik, është fusha e dytë më e madhe në Shqipëri, pas Myzeqes. Dhe edhe atje, në rast se bashkëpunohet ndërmjet dy bashkive të veçanta apo një bashki më e madhe, patjetër që efekti është më i madh sesa po të operonin dhe ke mundësi të implementosh më tepër projekte me impakt më të madh sesa po ta menaxhosh në mënyrë të ndarë. Dhe rasti i tretë është ai që ju referova në fillim, pra rasti i landfill-it, kur bashkimi, për shkak të ekonomisë së shkallës, sjell eficiencë të burimeve. Pra, ke kosto më të ulëta të menaxhimit. Dhe propozimin për të pasur një model mbi bazë qarku nuk është se ka ardhur nga ana jonë. Ka ardhur nga donatori. KFV-ja, bazuar mbi eksperiencën e saj, mbi projektet e ngjashme të zbatuara edhe në vende të tjera të Ballkanit edhe më gjerë, tha që në fillim që ky projekt, se kërkesa ka shkuar nga

Bashkia e Korçës, pas implementimit të dy projekteve të tjera infrastrukturore, ujësjellësit dhe kanalizimet, ato u bënë në nivel të qytetit. Dhe Bashkia e Korçës, në 2005-ën, ju drejtua me shkresë dhe tha: "Tani duam të na zgjidhni problemin e menaxhimit të mbetjeve, se e kemi fushën e mbetjeve ngjitur me qytetin." Dhe KfV-ja tha: "Jo, për menaxhimin e mbetjeve do shkojmë me një model rajonal. Përndryshe, modelet individuale do jenë shumë të kushtueshme dhe do jetë diçka që do jetë e vështirë për t'u menaxhuar dhe me kosto për familjarët." Këto janë ato tre raste ku unë shoh nevojën apo domosdoshmërinë e bashkëpunimit ndërmjet bashkive. Mund të ketë edhe raste të tjera. Po, pra, kryetar zotëri Mazniku është marrë më tepër se unë. Në një rast ju e përmendët dhe është ajo në vendin e fundit. Ideja është që këto dy tjerat që ishin, me sa kuptova, dëshira teorike. Jo, s'janë dëshira. Për turizmin, ne e kemi filluar punën dhe praktikisht jemi duke punuar për ta promovuar Korçën si një destinacion turistik, si qarku i Korçës. Individualisht, jemi shumë të vegjël dhe është një lloj marrëdhënie që nuk është konkurrencë. Nuk është se do zihemi tani çfarë do ndajë Korça me Pogradecin apo me bashkitë e tjera. Është win-win marrëdhënia. Duke pasur një ofertë më të plotë turistike, kemi mundësi të sjellim më tepër turistë në rajon dhe të qëndrojnë për një numër më të gjatë ditësh. Është një marrëdhënie nga e cila fitojnë të gjithë. Dhe ne po ta shohësh uebsajtin e bashkisë, do ta shohësh, e kemi krijuar ne si Bashki e Korçës dhe e kemi për të gjithë qarkun e Korçës. Promovojmë komplet destinacionin si qark.

#### **Arbjan Mazniku:**

Faleminderit. Po, zonja Penavini. Zonja Penavini.

#### **Ilir Pendavinji:**

Faleminderit, kryetar. Në fakt, unë këtu nuk jam në funksionin e anëtarit të Komisionit të Reformës Territoriale, por jam si deputet i Kuvendit të Shqipërisë, por edhe deputet i qarkut të Korçës. Dhe më intereson, meqënëse ishin kryetarët e bashkisë e të bashkive të qarkut tim, edhe të dëgjoja mendimet e tyre, por edhe të shprehja ndonjë konsideratë për pjesën e kësaj reforme të madhe, që besoj që ky komision i nderuar do të dalë me një produkt. Por në këtë, në këto seanca dëgjimore me kryetarët e bashkive të të gjitha qarqeve, nuk e kam vetëm për Bashkinë e Korçës, por e kam për të gjitha qarqet. E sigurt, po i merr pyetjen kryetarëve të bashkisë që doni të shkruheni, përgjigjja është jo. Po të bëni një formular e t'i thoni doni të shkruheni, përgjigjja do të jetë 100% jo. Doni të rriteni, përgjigjja do të jetë 100% po. Pse? Sepse të gjitha çfarë shikojmë, bashkitë më të mëdha gjithmonë performojnë në gjykimin tim. Mbase kam të gabuar, por ky komision do të japë një vlerësim në gjykimin tim që bashkitë më të mëdha nisin edhe pasqyrojnë më mirë punën, edhe bëjnë më mirë të ardhurat dhe zhvillohen më mirë edhe nga ana ekonomike. Dhe do të isha, unë të them se problemi themelor në këtë reformë nuk është në numri. Domethënë, edhe numri ka të bëjë, por pjesa kryesore që duhet të na shqetësojë të gjithëve ne është mungesa e këtyre funksioneve ose e decentralizimit që e ngritën edhe kryetarët e nderuar, që janë votuar njësoj si ne deputetët. Dhe në vend që të fokusohemi në numri, ne duhet të themi cilat janë kompetencat reale dhe cilat kompetenca doni kryetarë që t'ju transferohen. Rritja, rritja e rritja e autonomisë financiare, a është e duhura

apo doni akoma më shumë autonomi financiare ose forcimi i kapaciteteve të administrimit? Po lexoja për se si funksionon legjislacioni në Bashkimin European dhe 70% e buxhetit të Bashkimit European, të legjislacionit, po jo të buxhetit, të legjislacionit të Bashkimit European, zbatohet dhe mbikëqyret nga pushteti vendor. Atëherë, në kushtet që është Shqipëria, që jemi duke ecur drejt Europës dhe pretendojmë që në 2030-ën të anëtarësohemi, të mbyllim kapitujt në 2027 deri në 2029-n dhe të kemi mundësi të anëtarësohemi. A i kemi ne... Po ja u bëj të gjithëve dhe mundet që gjithsecili të përgjigjet, që mund të ketë përgjigje. A i kemi ne kapacitetet administrative, ekspertizën apo burimet e bashkive tona për të menaxhuar, qoftë edhe mënyrën e AKI komunitare që nevojitet që bashkitë tona të performojnë në Bashkimin European? Pasi e tyre, sepse duhen bashki më të mëdha, numra më të mëdhenj për të thithur sa më shumë fonde dhe të... Keni pasur juve vështirësi në thithjen e fondeve ose në projektet e përbashkëta me Bashkimin European për pjesën e madhësisë së bashkive tuaja? Në qoftë se keni, keni, keni aplikuar dhe a ju janë përgjigjur ose keni pasur ndonjëherë dështime në këto, në këto projekte ku keni aplikuar? Për të rritur... Pyetje tjetër. Për të rritur zhvillimin ekonomik të bashkive, cilat do të ishin kompetencat që do të rrisnin më shumë... që çfarë mendoni ju që do të rrisnin performancën e bashkive tuaja?

#### **Pali Kolefski:**

Faleminderit. Mund të përgjigjem unë, pavarësisht që jam edhe më i vogli. Përsa i përket përrithjes së fondeve të Bashkimit European, unë mendoj që madhësia nuk ka të bëjë fare. Ne jemi në të gjitha projektet, pothuajse në shumicën e projekteve që kemi aplikuar me Bashkimin European, me Bashkimin IPA Cross Border ose Interreg, në shumicën e rasteve kemi marrë fondet edhe jemi shpallur fitues. Bile se kemi realizuar me shumë sukses një nga ato projekte, është shpallur si realizimi më i mirë i thirrjes. Ka qenë IPA Cross Border dy me Maqedoninë e Veriut. Për momentin, Bashkia pushtetësisht domethënë është në një sirth, është aplikante në një sirth thirrjesh me Bashkimin European dhe jemi duke krijuar dhe gati është duke përfunduar e GTC-ja, që është midis bashkisë tonë, bashkisë së Resnjës në pjesën e Maqedonisë së Veriut dhe bashkisë së Prespës në pjesën e Greqisë. E kemi ftuar edhe Bashkinë e Devollit, e cila do të jetë firmëtare për të vazhduar këtë. Edhe besoj se ka mënyra që ky është një model bashkëpunimi midis gjithë bashkive, qoftë brenda qarkut tonë, por edhe në rajonin. Grupi e GTC-ve e GTC, domethënë, edhe është një mënyrë shumë e suksesshme për të aplikuar në fondet e Bashkimit European dhe për t'i aksesuar ato jo vetëm kur kanë thirrje, por edhe direkt, duke patur një lider nga ana e bashkive të Bashkimit European. Përsa i përket pyetjes së parë, kurse pjesa e dytë që e përmendët, domethënë, po më thua që në bashkitë tuaja ekzistojnë kapacitete, kapacitete, sepse të gjitha thirrjet, pothuajse të gjitha thirrjet, pothuajse të Bashkimit European, siç është edhe URBAK-u tani së fundmi, kërkon jo vetëm një bashki, kërkon edhe bashki të tjera. Për shembull, nga pjesa shqiptare mund të vijmë dy ose tre bashki, të cilat me një marrëveshje, atëherë është më i besueshëm si projekt edhe mundësitë për t'i marrë janë akoma më të mëdha për të për ta fituar këtë projekt, varësi të partnerëve që zgjidh, edhe vetë se duhet të jesh, domethënë, duhet të kesh edhe partnerët e duhur nga ana tjetër e kufirit. Kurse për pjesën tjetër, unë do, unë do të e përmenda në fillim, edhe gjithmonë është një problem shumë shqetësues për bashkinë.

Kundrejt të saj është zona e mbrojtur. Në Slloveni është një model, pse nuk shikohet edhe në Shqipëri, domethënë, një bashki sa tona nga madhësia, nga sipërfaqja, 100% zonë e mbrojtur, siç është bashkia pushtet, 100% zonë e mbrojtur. Siç përmendët edhe juve, domethënë, që e të ardhurat e bashkisë pushtet janë shumë të ulëta, domethënë, me nga targutat e veta, është e vërtetë, por në një zonë që është 100% zonë e mbrojtur, çfarë mund të pretendosh tjetër me ligjin legjislativ aktual shqiptar? Kurse ke përgjigje? Jo, jo, po e them, po e shpjegoj edhe me një arsye. Në Slloveni, zona e mbrojtur, shteti, veç grantit që i dërgonte, dërgonte edhe pjesën e të ardhurave të munguara kësaj bashkie, për shkakun se është një zonë e mbrojtur, duke për ta ruajtur natyrën që ne do ta mbajmë këtë zonë kështu të mbrojtur. Por ishte ngritur një komision që vlerësonte sa ishin të ardhurat e munguara për këtë bashki, në qoftë se ajo do t'i shfrytëzonte këto pyje, këto gjëra, këto resurse, vetë, edhe vinte në formë granti. Po mund të gjendet edhe një mënyrë tjetër, domethënë, Ministria e Mjedisit, pavarësi, pavarësisht se është zonë e mbrojtur, të ketë vetëm rol monitorues edhe këshillues, kurse të ardhurat që nxirren nga të gjitha aktivitetet në këtë zonë të mbrojtur, e të ketë më shumë aktivitete që duhet të bëjë bashkia. Çdo lloj bashkie, nuk po them rastin tonë që neve që jemi 100% në zonë e mbrojtur, të gjithë bashkitë, 100% na pengon në qenien e legalizimit, që është një nga, një nga, domethënë, kjo reformë këtë duhet të ndajë. Mendoj që duhet t'i shikojmë këto problematikat edhe duhet të ulemi me çdo bashki, qoftë edhe në bashki pushtet, që është bashkia më e vogël. Ndoshta do të kuptoni disa gjëra që mund të përmirësohen edhe në bashki të tjera. Faleminderit.

#### **Arbjan Mazniku:**

Faleminderit. Atëherë, ëh, po, zoti Boçi, një koment tuajin, pastaj ta mbyllim besoj.

#### **Luçiano Boçi:**

Një koment, ndoshta dy, tre pyetje të vogla të shpejta. Po, nga ajo çka dëgjova, nderuar kryetar bashkish, ëh, unë mendoj që t'i bëjmë një propozim këtij komisioni që qarkun e Korçës ta përjashtojmë nga reforma territoriale, se që e ka kaq bukur, kaq mirë, sa shqetësimi kryesor që e ka ai pluri, që zëtori që kalon te rrugët e arave, na e mbulon nga mollën. Edhe kur të bëjë Zvicra të vetën, t'i kërkojmë ndihmë që të na bëjë edhe këtë reformën e territoriale të qarkut Korçë. Niset nga parametrat tuaj të ekonomisë, shërbimeve, zhvillimit, se e tillë u paraqit situata. Jo, është e propozim, është ky propozim, pastaj votojeni. Jo, jo, ka qenë prandaj, po prandaj, prandaj edhe unë, prandaj edhe e kam këtë lloj propozimi. Ndërkohë që po të futemi në realitet, mirë se vini në realitet, nga të dhënat reale dhe aktuale, Korça është ndër qarqet që ka nivel shpopullimi shumë të lartë, gati 20% nga censusi në krahasim i 2011-s me 2023-shin. Bashkia Korçë ka humbur 20% të popullsisë, ndërsa qarku 21% të popullsisë. Dhe besoj që ka korrelacion kjo në raport me performancën e bashkive, në raport me arsyet pse një qytetar duhet të qëndrojë në bashkinë që është, ose në bashkitë që janë kaq shumë të lumtura, ose pse duhet të largohet, siç është larguar përgjatë këtyre viteve. Dhe patjetër që unë mendoj që ka korrelacion në raport me shërbimin, në raport me përfaqësimin, në raport me dhënien e llogarisë, në raport me cilësinë e shërbimeve arsimore, shëndetësore, apo të shërbimeve

tjera sociale, të cilat këtu duket sikur janë uniforme. Pra, shërbimi siç e merr ai në qendër të Korçës, e merr ai banori i Panaritit, apo banori i Vitkuqit, gjë që nuk është e vërtetë, se ky është realiteti dhe ky trend shpopullimi është kudo. Në fakt, Korça është shumë atraktive dhe ka dhe një nonsens. Ka rritur turizmin, po, e ka rritur turizmin. Shkaku kush është? Rritja e shërbimeve edhe rritet turizmi, por për shkak të shërbimeve ka ulur popullsinë. Se dalim çelësi që e ka shërbimi. Shërbimi rrit, shërbimi zvogëlon. Pra, ne rrisim shërbimin për turistët dhe ulim shërbimin për popullsinë dhe popullsia ikën, turisti vjen. Kjo është ideja dhe kam një pyetje: a nuk duket që është nonsens? Pra, a duhet të korrigjojmë këtë lloj shërbimi? Dhe në këtë kuadër kam një pyetje për të gjithë, por sidomos ato që janë bashki që janë urbane dhe rurale. Shërbimi këtu pak a shumë, zoti Filo e tha, por unë nuk jam shumë dakord edhe dua përgjigjen shumë më të saktë. Shërbimi është i njëjtë dhe i barabartë si për qytetarin në Korçë dhe i njëjtë dhe i barabartë si për qytetarin në Vitkuq, pra në Panarit, apo në shtyllas, mos gaboj, apo domethënë ç'e donë, sepse është larg. Aksesueshmëria është një element shumë i rëndësishëm dhe pyetja tjetër ka të bëjë sa është pika më e largët, sa i duhet qytetarit më të largët të bashkisë së Korçës që të arrijë qytetin, se ka një standard europian, se e keqpërdorim shumë Europën. Standard europian në raport me popullsinë që është 6000 mesatarja, nuk për Shqipërinë s'ka shumë rëndësi, se është 40000, dhe ka një raport të lartësisë që ai të marrë shërbimin, që është 30 minuta me shërbim urban. 30 minuta të vijë në qendër dhe 30 minuta të kthehet. Është standard totalisht europian për menaxhimin e territorit, për ta bërë të madh, apo për ta bërë territorin të vogël. Dhe të gjithë mund të më jepni një përgjigje. Në raport me performancën e të ardhurave për autonominë fiskale, këtu u tha nga zoti Elezi që bashkia e madhe performon më mirë. Korça është tek nivelet mbi 50%, 53% në sigurimin e të ardhurave nga taksat vendore dhe mos gaboj, pushteti ishte më keq, 14% dhe logjika e shifrave na çon tek argumenti që bashkia të jetë performante, duhet të jetë e madhe. Në fakt, këtu hiqet matematika e thjeshtë, sepse zgjidhja mund të gjendet edhe në forma dhe mënyra alternative që ne kemi thënë. Po t'i bashkosh dhe t'i bësh më të mëdhaja, unë nuk besoj që do bëhet 60%, se duhet t'i bashkosh edhe logjika matematike i bie që të bjerë autonomia fiskale. Dhe po jap një argument: para reformës, vetë bashkia e Korçës e ka pasur autonominë 69%. Pse ndodh kjo? Sepse normal është intensiteti i bizneseve. Edhe sot, Bashkim Korçë, po ta bësh vetëm qyteti, do e ketë më të madhe se bashkia sot aktuale e Korçës, se është logjika e pasjes së biznesit. Kjo nuk do të thotë që kjo logjikë matematikore duhet të na çojë ne në shkrirjen e bashkive mesatare apo të vogla, se nuk ka logjikë. Besoj që e ardhura që merret nga qyteti i Korçës është ku e ku me të ardhurën nga Vitkuqi, apo nga Panariti, apo njësitë e tjera administrative. Dhe ne këtë po kërkojmë, që ka disbalancë të funksionalitetit të territorit në bashkitë e mëdha. Ka diskriminim, ka diferencë zhvillimore që pasqyrohet në këto elemente. Për investimet që kanë rënë, kam një panoramë këtu me shifra. Ju thatë që janë vënë shumë drita për 12 vite, mua më duket gjë fare e vogël. Që janë pastruar kaq kanale për 12 vite, prapë më duket gjë e vogël, se 12 vite janë shumë, janë një dekadë në jetën e një komuniteti. Se po të ishte krahasimi për një vit për dy vite, unë do isha në dakordësi të plotë. Por të shohim nivelin e investimeve si kanë qenë. Në 2010-ën, zoti Filo, ju e keni marrë detyrën në 2013-ën, mos gaboj, po e keni gjetur, ka qenë 699 milionë Korça, vetëm Korça, bashkia Korça e atëhershme, 699 milionë lekë. Po, investime. Po, po, investime, lekë investime. Ja ta

sqaroj: në 2015-ën është rritur, po ta këtu mund të ma verifikosh, 927 milionë është rritur në 2015-ën. Po, në 2022-in ka rënë 293 milionë. Ka rënë. Në 2023-in ka rënë 195 milionë, në 2024-in është 340 milionë. Deri këtu janë të dhënat. Pra, në krahasim me 2010-ën, është gjysmë për gjysmë kur bashkia ishte qytet. Kështu që prit, mos lavdërohem kaq shumë. Ne duam t'i rrisim investimet. Saktë, këto të dhëna që marrim, këto të kemi nga të dhënat që pasqyroni ju online. Ne si komision kemi kërkuar, jo se i kanë nxjerrë ekspertët, domethënë, nuk e kam gabim, nuk i nxjerr vetë unë. Po, po, jo, nuk besoj. Ekspertët tanë kanë kohë që punojnë, kanë kërkuar materiale shtesë edhe nga ju si bashki. Besoj ju ka ardhur shkresa. Besoj e keni dhënë përgjigjen. Besoj, po. Po, përderisa s'ka rritur përgjigjja, po mirëpo, pse domethënë shërbimet online që i merr qytetari për sekonda? A mundesh që ky shërbim të vinte online për komisionin e reformës dhe të dëshmoresh që gjërat funksionojnë shumë online në Shqipëri? Se kemi nevojë për shembuj. Ju për një material që e kërkon komisioni, ju nuk e sillni online menjëherë. Sa vjen kërkesa, dërgohet. Nese këtë sot ka ardhur, kemi dy muaj që e kemi kërkuar nga ekspertët tanë dhe ka probleme të tjera. Pra, ja pra një dëshmi që bashkia e madhe, nuk e kam për ju personalisht si drejtues së bashkish, e kam për bashkinë e madhe apo të vogël, se duhet të kundërshtoj argumentin që të voglat duhet të përpihen nga të mëdhat, nuk që e ka kaq performante. Dhe në qoftë se është, mbetet nga ai organizim bashkish i madh që ka përqendrimë popullsisë për shkak të qyteteve kryesore të Shqipërisë, si Durrësi, Tirana, Korça, Elbasani, ndërsa shtrirja ka krijuar këtë lloj diference. Meqënëse këtu u thanë gjëra shumë të mira nga reforma, se ishte shumë e bukur, për të cilat ne jemi bërë pishman, nuk jemi bërë pishman hiç, zoti Filo, sepse po doja të kërkoja drejtën e vetes dhe kërkoj që dhe varianti i saj të ishte i fuzionuar, fjalë e vërtetë, shëndet, të ishte i fuzionuar me variantin e PS-së dhe të kishim një vendim të unifikuar, konsensual, siç po e kërkojmë edhe sot në këtë komision. Duhet një vendim konsensual, se ka kërkesa të ndryshme me synim rritjen e funksionalitetit dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarit. Dhe meqënëse u thanë shumë gjëra, cilat janë problemet që reforma nuk arriti t'i zgjidhë sipas jush? Problemet, se shumë gjëra ju thonë që i kanë përmirësuar këtë, e ka bërë këtë. Cilat janë problemet? Se ne duam problemet që ne të marrim masa ligjore me qëllim që problemet të mos ekzistojnë më. Dhe dua t'ju ngacmoj pak, domethënë, në lidhje me autonominë, se autonomia është element shumë kyç në ushtrimin dhe efikasitetin e pushtetit vendor. Pati para disa kohësh një urdhër nga kryeministri për ndërrimin e drejtuesve të bashkive tuaja. Unë nuk besoj që është kompetencë e kryeministrit, por dua të di nga ana juaj sa e zbatuat urdhërin e kryeministrit dhe a mendoni që ky urdhër që vjen nga kryeministri çënon autonominë tuaj vendore si drejtues bashkish, apo është një proces normal rifreskimi administratë sipas urdhrit që vjen nga qendra, që do të thotë që jeni shumë të pavarur? Dhe nga 42 funksione që përcaktohen në ligjin organik, janë 42 funksione. U tha këtu që ato funksione që nuk shoqërohen me kompetenca dhe financë, më mirë të mos na ishin dhënë, zoti Topçiu, ju e thatë. Atëherë, po, edhe unë jam dakord, sepse një nga pikat që unë kundërshtoj shumë dhe jam shumë kritik është kjo gjë: mospërputhja e funksionalitetit, funksioneve me kompetencat dhe me pjesën e financave. Dhe cilat janë këto funksione që ju i shihni që nuk ju shkojnë përshtatë, nuk i realizoni dot? Nuk e kam për pushtetin, se e di që sa kompetenca, aq funksione duhet të ketë. Dhe normal që duhet të qëndrojë si bashki, ka shumë argumenta, jo vetëm thjesht identiteti,

por shumë argumenta të tjera. Dhe meqënëse jemi po këtu te funksionet, një, tek kompetencat dhe tek ana financiare. Kur u përcaktuan këto, zoti Filo, u tha që reforma do shkurtojë administratën. Po kishte në konsideratë funksionet, kompetencat dhe financat. Përkundër këtij parashikimi, pra ata që hartuan reformën, ju si forcë politike, pretenduat që duke lidhur këto, ju do i shkurtoni. Kurse ju sot më jepni argumenta të mua që funksionet, rritja e funksioneve, kompetencat çuan në rritjen e... në rritjen, ja, një minutë, sepse ju parashikuat tjetër gjë, nuk e thamë ne dhe e bëtë vetë ju reformën, pa ne. Dhe sot, përkundëjt këtij arsytimi... E përmend zoti Filo, kjo është e saktë. Jo, jo, e kam fjalën, ngjo, zoti Filo, jo fare, por tha ju, ai ndërtoi kundërvënien, ju dhe ne, dhe unë po i përgjigjem me të njëjtën monedhë. Jo se unë kam... ngjo, se në qoftë se ka, Filo, në qoftë se ka në një fajtor, një ndër është bashkëkryetari, sepse ky u mërzi që pse nuk i them unë që ka ky faj, se po drejtohem ty në këtë rast. Pra, si e shpjegoni ju këtë nonsens? Pra, nga shkurtimi i administratës, ju arsyetoni me të njëjtat argumente rritjet. Dhe pjesën tjetër e kam për kompetencat. Ju jeni dakord që ligji për planifikimin urban ndërhyt në kompetencën tuaj për planifikimin urban i miratuar pas miratimit të ligjit organik për pushtetin vendor. Dhe në këtë vazhdë, ju mendoni që ligji për turizmin ndikon në kompetencat tuaja? Ligji për pyjet, a ju heq ju kompetenca? Ligji për ujërat, a ju heq ju kompetenca? Ligji për mbetjet, se folët këtu për mbetjet, shumë mirë, çfarë kompetence ke ta bësh në rang qarku? Ti nuk e ke kompetencën tani me ligjin real, sepse krijohet agjencia... Po, po, shtetërore. Po, jo, jo, tani nuk ke kompetencë për menaxhimin, dakord? Pra, a ndërhyt? Kjo është pyetja ime. A ka ndërhyrë këto ligje sektoriale? A ka ndërhyrë kompetencat tuaja? Kështu që është shumë e rëndësishme kjo. Pra, këto kompetenca ju janë marrë ju nga... kush jua ka marrë? Opozita? Apo qeveria përgjatë këtyre viteve? Kështu që është shumë e rëndësishme. Dhe prandaj jemi këtu, zoti Filo, që ne të themi këto gjëra me zë të lartë, se unë e di shumë mirë përgjigjen e këtyre, që janë marrë dhe ne duhet t'i rikthejmë. Duhet t'i thoni dhe ju dhe ne, se kur i thotë opozita, duket ne i themi për arsye politike. Kur i thoni ju, ai qytetari që e dëgjon thotë: "Po, ka të drejtë kryetari i bashkisë." Kurse opozita, hamendëse bën politikë dite, do të sulmojë kryeministrin. Ndërkohë që kryeministri jua ka marrë të gjitha kompetencat me këto ligje organike. Dhe pjesa tjetër, në fakt, e kam më shumë për parashtrim, jo pyetje, se bashkia Kolonjë doli që ka bërë shkolla shumë moderne, arsimit është bashkëkohor, zona ka atë dashurinë e madhe të vet për arsimin, e di shumë mirë, domethënë, meqënëse jam i kësaj fushe, kam pasur kontakte edhe nga studentë që vijnë nga ajo zonë dhe kanë shkuar gjithmonë për inteligjencën dhe dëshirën e tyre për të marrë dije. Por ka një problem shumë të madh me këto shkollat e mira që janë bërë në Leskovik dhe nuk po i referohem shumë të dhënave, vetëm një të dhënë që e kam dëgjuar vetë nga zoti Mazniku. Përgjatë një viti ka pasur vetëm një lindje në Leskovik për shkak të shpopullimit. Dhe pyetja ime është: kemi nxënës ne për këto shkolla? Se nuk është çështja që kemi shkolla, kemi më shkolla kudo në Shqipëri, nuk kemi një hartë shkollore efikase. Unë do të doja që shumë kompetenca për arsimin të kalojnë në bashki, sepse bashkia do të na ndihmonte me një hartë shkollore shumë më efikase se ç'mund ta bëjë qendra. Ky është gjykimi im, pak e njoh arsimin, aq pak sa e njoh. Dhe gjykoj që një hartë shkollore është e domosdoshme në këto situata demografike lëvizje populsi. Pra, mos themi vetëm këtë pjesën që i kemi bërë bukur shkollat, se shkollat janë investuar gjithmonë. Çështja është shpopullimi, si do t'i kthejmë

tritë, si Leskoviku do të kthehet në pozitivitet në atë, si jo vetëm Leskoviku, sepse edhe Korça ka lindshmëri negative për herë të parë në tre mujorin e parë, e gjithë Shqipëria, edhe Durrësi, edhe Tirana, me përjashtim të një qarku që është Berati, në atë statistikën nga vetë instati jonë kanë ardhur. Pra, kjo është situata dhe unë desha përgjigje shumë shpejta, se ndoshta, domethënë, ju mbajtëm gjatë, jemi në limitet e kohës. Thjesht saktë edhe pa parashtrime ndoshta të gjata, se i kemi bërë ne, i kemi bërë dhe ju përgjatë kësaj kohe dhe mos të kalojmë përsëri. Faleminderit.

### **Sotiraq Filo:**

Faleminderit. Është e vërtetë që u zgjat pak, po e parë kështu në sensin pozitiv, besoj që u zgjat për shkak se argumentat që kemi dhënë kanë pasur një lloj vlere. Unë kështu dua ta shoh. Tani po i përgjigjem shkurtimisht pyetjeve, se ishin shumë në fakt. Unë mendoj, dhe jo mendoj, por realiteti e tregon që reforma administrative territoriale ka favorizuar zonat më të pazhvilluara. Pra, në vijim të asaj që e pyetët edhe ju, po, në rast se do të ishte vetëm një bashki, sa qyteti i Korçës, mbase mund të kishim bërë më tepër me të ardhurat që gjenerojmë nga qyteti. Por, por, po kjo është pozitive, në sensin që falë reformës edhe komunitete më të pafavorizuara, siç janë fshatrat apo njësitë, kanë patur mundësi të marrin investime që s'do kishin shans t'i merrnin. Dhe konkretisht, në planifikimin e Fondit për Investime në Infrastrukturë Rrugore që kemi bërë për këtë vit, i gjithë fondi i dedikohet njësisë administrative, sepse qyteti është i investuar në masën 100% brenda pjesës formale, brenda UNAZ-ës, dhe ka vetëm nevojë për investime në disa nga zonat informale, se edhe atje kemi investuar. Pra, ky është argument pozitiv në favor të reformës. E para. E dyta, a është i njëjti nivel shërbimesh si në qytet, si në fshatra? Jo. Fshatrat kanë nivel më të ulët të disa shërbimeve. Dhe, po, po, cilat janë arsyet? Dhe mendoj që reforma po jep kontribut që ky gap, kjo diferencë ndërmjet gjendjes së infrastrukturës apo të shërbimeve në qytet me përafrimin me gjendjen e infrastrukturës në fshat dhe shërbimeve, të ngushtohet në një afat kohor sa më të shkurtër. Nuk ka pretenduar njeri. Për shembull, Korça është bërë me... ka realizuar furnizim me ujë të pijshëm që në vitin 2003. Ndërkohë që me fshatrat, vetëm së fundmi kemi arritur që ta normalizojmë situatën. Kanalizimet në Korçë kanë mbaruar brenda qytetit që në vitin 2013-2014, por gjendja e kanalizimeve në fshatra është... vazhdon të lërë shumë për të dëshiruar. Po, po këto problematika ekzistojnë, këto si fsheh njeri, por reforma jep kontribut që t'i zgjidhë në një afat më të shpejtë kohor, domethënë nuk është se i përkeqëson situatën e tyre. Unë mendoj që jep kontribut në sens pozitiv. Përsa i takon shërbimeve më të këqija pas reformës, ju sfidoj dhe ju them cili shërbim në cilën zonë është ofruar më mirë para reformës dhe më keq pas reformës. Mund të mos jetë... Po tani unë ju dëgjova... Po jam përkeqësuar? Shiko, t'ju përgjigjem njëherë si i kam mbajtur pastaj... Jo, jo Lucianon.

### **Luçiano Boçi:**

Jo si i ke mbajtur ti, si i kam bërë unë është shumë e rëndësishme. Sepse unë e kam shkruar pyetjen dhe e kam lexuar. Cilat janë problemet që reforma nuk arriti t'i zgjidhë? E ka, është pyetje tjetër kjo. Jo, jo, po ajo është e shërbimeve ishte diferenca, kaq.

**Sotiraq Filo:**

Po e lëmë.

**Luçiano Boçi:**

Po jo, po e lëmë, po... Jo, do vij dhe do vij dhe te kjo pyetje. Kjo është pyetja. Cilat janë... sepse ishte nga pyetjet e para, e dyta ishte kjo. Cilat janë problemet që reforma nuk arriti t'i zgjidhë?

**Sotiraq Filo:**

Dakord, mirë atëherë, të gjitha shërbimet pas reformës kanë pësuar një përmirësim në një nivel të caktuar. Përsa i takon cilat problematika nuk u zgjidhën me reformën? Tani, nuk mendoj që reforma u konceptua si një shkop magjik, që do bëhej reforma dhe do zgjidheshin të gjitha problematikat. Po çfarë ishin objektiva të reformës? Unë besoj që rezultuan të suksesshme në sensin që këto tregues u përmirësuan, por pa arritur në zgjidhjen përfundimtare. Pra, kush ishin objektivat? Eficiencë ekonomike? Po, tani 100% nuk e di se çfarë, kush është ai, se gjërat janë relative. Do e bëjmë se është pra 100%, se e kemi 99%. Do bëjmë këtë reformën, do e bëjmë 100%, thoni ju. Gjërat, gjërat janë relative, po them. Pra, në rast se një shërbim X para reformës ishte në nivelin këtu, pas reformës erdhi këtu. Ka vend për t'u përmirësuar? Po. Tani, reforma nuk kishte shkop magjik. Reforma kishte disa... nuk di, nuk di ndonjë objektiv të reformës i cili nuk u realizua në sensin që nga gjendja X të shkonte në gjendjen Y më të përmirësuar se X-i. Po kjo s'ka lidhje me reformën. Me reformën... tani... Jo, s'ka lidhje. Funksionet nuk kanë lidhje me kompetencat. Pardon. Mirë, po vazhdoj. Si mos kanë? Tani reforma administrative dhe territoriale, po flisja për këtë, jo për reformën e decentralizimit të kompetencave.

**Luçiano Boçi:**

Zoti Filon, vjen keq se ke kaç vite në pushtet lokal, janë bashkë. Tani, po tani edhe... Po janë bashkë, mos si s'ka lidhje kjo e decentralizimit apo e kompetencave. Ajo ishte decentralizuese në mënyrën se si i përcaktoi objektivat dhe qëllimet. A arriti decentralizimin? Dhe funksionet që tha zoti Topçiu, nuk përputhen me kompetencat.

**Sotiraq Filo:**

Po pse nuk më nxirrte mos... edhe unë s'mund të...

**Luçiano Boçi:**

Po sepse dua, domethënë, dua që mos devijohen përgjigja, se dua problemin, unë nuk dua të dalësh ti i keq, jo fare. S'ka lidhje. Po më nxjerr keq sa të duash, po arrite të më nxjerrësh, nuk ka problem. Po që të komunikojmë... S'ka lidhje, mos as e kam objektiv as që dua problematikat e reformës aktuale nga zëri juaj, nga goja juaj.

**Sotiraq Filo:**

Që të komunikojmë në mënyrë civile, duhen, duhet, duhet, duhet një letër, një laps, edhe bon sensi që kur flet tjetri mban shënime. Pastaj flet ti, mban tjetri shënime. Tani unë flas, ti më ndërpret. Si bëhet kjo punë? S'bëhet.

**Luçiano Boçi:**

Kjo bëhet që ju shënimin tim ta kishit marrë të saktë. Se thatë që e kam shënuar ndryshe. E po, ja pra që e gjete bon sensusin me fjalën tënde dhe parashtrimin tuaj. Është shumë e thjeshtë kjo.

**Sotiraq Filo:**

Përsa i takon distancës kohore të lidhjes të fshatit më të largët me qendrën, pra me qytetin e Korçës, u përmend Panariti dhe unë dua t'i referohem Panaritit. Panariti është një nga fshatrat... është një nga fshatrat më të largëta të bashkisë së Korçës, mbrapa një qafe, qafa e Mashkullorës, me lartësi 1800 m, ku dëborë në dimër arrin lartësinë edhe mbi 2 m. Dhe Panariti, para reformës, bllokohej, po kur them bllokohej, nuk vinin dot fare në Korçë në muajin nëntor, bllokohej nga shirat sepse kishte ca pjesë që ishin me baltë. Pra, bllokohej në muajin nëntor dhe mundësohej komunikimi në muajin mars. Sot që flasim, Panariti komunikon gjatë të gjithë vitit, mund të ketë ndonjë incident kështu 24, më pak se 24 orë kur bie ndonjë dëborë e madhe, dhe distanca kohore nga Korça duhet të jetë rreth një orë e çerek. Ndërkohë, më përpara thashë gjashtë muaj, gjashtë muaj nuk vinin fare, bënin furnizim dhe kur çelte gjethi, kur çelte gjethi, vinin në qytet. Po me kë ta krahasoj tani? Me... Krahasoje me 1938-ën, ç'të them unë ty? Krahasoje me pritshmëritë. Po me para reformën, po e... Po krahasoje me pritshmëritë, më kam... na shkoi goja. Pritshmëria e Panaritit ishte që rruga të ishte e hapur. Rruga është e hapur.

**Luçiano Boçi:**

Që në fillim, pritshmëria është standarti evropian. Në qoftë se doni që talleni me banorët e Panaritit që paskën dashur kaq gjëra minimale, prandaj është një nga vendet më të populluara, se është kjo qasje. Jo, jo, është kjo qasje, është kjo qasje që bëni ju, prandaj dhe njerëzit kanë ikur atje, se ja paske plotësuar Panaritit ti, se i paske hapur rrugët.

**Sotiraq Filo:**

Po mirë, tani do më komentoni pas çdo pritshmërie.

**Luçiano Boçi:**

Jo, jo, të bëj pyetje. Panaritin, kush e ka pasur në administrim?

**Sotiraq Filo:**

Partia Demokratike.

**Luçiano Boçi:**

Po, gjithë vitet. Partia Demokratike. Po keni 12 vite, mo keni 12 vite, akoma ju ka ngelur, ju ka ngelur ora dhe pas 12... Në mandatin, në mandatin, zoti Filo, po mirë, më vjen këtu pas 12 vitesh, është administruar nga Partia Demokratike. Më vjen këtu pas 12, vjen mas 12 vitesh dhe më thua që sukcesi i Panaritit është që i heqim borën. Po tani dreqi ta hajë, domethënë, mos, mos dili deri këtu, se është cinizëm me njerëzit kjo. Po është cinizëm. Tani, po të vazhdojë ky regjim, komenti pas çdo përgjigje, po e mbyll këtu. Po jo, po e vazhdon ti se ti e merr. Unë të pyes për distancën, ti më thua kur bie bora dhe shiu.

**Sotiraq Filo:**

Po distanca, po ta themi, ishte katër orë. Po të lutem, edhe për distancën, bëri një orë e çerek. Tani, si të ta them?

**Arbjan Mazniku:**

Po tani, o zoti Boçi, të lutem.

**Sotiraq Filo:**

Po mirë, shko pyeti banorët e Panaritit se çfarë kanë shqetësim real, se tani që këtë distancën e gjejmë në Google Maps. Pyeti kryetari i bashkisë, pyeti ti, domethënë. Dakord, mirë atëherë. Po kur të vijë atje Panariti, me këtë regjim, me këtë regjim komentesh, unë po e lë këtu se s'ka më kuptim kjo pjesë. Mund të vazhdojnë kolegët.

**Arbjan Mazniku:**

Ka dikush nga kolegët diçka për shtuar?

**Luçiano Boçi:**

Komentet s'kanë regjim, kanë regjistër. Regjimet janë politike, janë ideologjike, kështu që të lutem shumë t'i saktësojmë ca gjëra. Po ju keni akoma regjimin në kokë edhe ju ka ngelur regjimi.

**Sotiraq Filo:**

Po mirë, pra tani kemi dhe njohje personale.

**Luçiano Boçi:**

Po kemi, mo Filon, zoti Filo, më vjen keq as po të fyej asgjë. Unë dua një... Po s'është fyeje. Jo Lucianon, unë dua një përgjigje koncize për shkakët e menaxhimit të ekonomisë së kohës. Prandaj thashë sa është distanca kur në Europë është 30 minuta. Kaq më...

**Sotiraq Filo:**

Jam inxhinier, edhe po ma bëj gjatë, unë ta bëj shkurt. Nuk është...

**Luçiano Boçi:**

Po kaq më... Kaq po të them e...

**Sotiraq Filo:**

Po tani dy fjalë do t'i themi.

**Luçiano Boçi:**

Po mirë, më kaq gjatë.

**Sotiraq Filo:**

Po dëgjo, mbaj shënim, flas unë, më ndërpret. Vazhdo shumë gjatë, vazhdo, nuk do të ndërpresë.

**Luçiano Boçi:**

Po jo, s'mund ta... Jo, s'mund ta lësh përgjigjen ndaj komisionit se as përdorëm epitete, asgjë. Tani, normal që ne duam të orientojmë përgjigjet, thashë, me bon sensusin. Bon... Asnjë lloj desha, asnjë lloj. Gjo, zoti Elezi, ka një gjë, ka një gjë, edhe një herë, edhe një herë, këtu është diferenca. Çfarë kërkoj unë dhe çfarë thotë? Sepse unë po pyes shumë konkretisht sa është distanca, më kaq, asgjë tjetër. Dhe kam bërë dhe pyetjet e tjera për ekonominë e kohës, më i voni e zgjatë. Po keni bërë jo vetëm rastin konkret, po jo,

**Arbjan Mazniku:**

Më fal, them unë një gjë. Kemi bërë gjithë pyetjet tani. Çështja është, nuk thritet kryetari i bashkisë për të thënë sa është distancë. Distancën nga në Panarit e gjejmë, e gjejmë në Google Maps. I me hap Google Maps-in, i themi tani sa është distanca këtu. Na e thotë, është 13.2 km. Pra, nuk dobia e kryetarëve të bashkisë. Po ne, unë nuk po bëj komente për pyetjet dhe mendoj që siç nuk bëjmë komente për pyetjet, sens bën të mos i bëjmë njerëzve komente për përgjigjet. Kaq.

**Luçiano Boçi:**

Kur të hipi te makina ime dhe do shkoj në Panarit, do fus Google Maps-in, të jesh i bindur për këtë, dhe do marr kilometrat sipas rrugës nacionale. Kështu që këtë e bëj gjithmonë. Nuk e kam nevojë për këtë këshillë. Ndërsa në rastin konkret, unë e konceptoj jo nga makina ime, por e konceptoj nga mundësia që ka qytetari i Panaritit për të aksesuar bashkinë e Korçës. Pra, kam qasje krejt ndryshe nga ajo që parashitrova ti, se këtë e gjej vetë unë. Po, makina ime ecën shumë shpejt, kurse ai qytetari do s'ka makinë, do transport urban dhe kjo na intereson të diskutojmë bashkë. E kam shumë serioze dhe s'ka pse e fusim në kanale të tilla dhe unë t'ia përgjigjem pastaj që i prekin edhe të ftuarit, i prekin, se do përdoret ironia, do përdoret ndonjë gjë tjetër, do mund të tejkalohet fjala, por mos e ngacmojmë njëri-tjetrin se s'ka pse. Po ashtu do ketë një përgjigje. Prandaj, zoti Filo, në qoftë se ka pyetje tjera pa përgjigje, mund t'i japësh përgjigjen. Tani, meqënëse u bë kjo situatë sipas dëshirës, e kemi, e kemi emision sipas dëshirës së të ftuarve. Vazhdojeni edhe pa kryer.

## **Sotiraq Filo:**

Tani, po tani edhe njëherë, kërkuam vetëm një gjë minimaliste: na dëgjoni kur flasim. Mirë atëherë, edhe një pyetje: kompetencat e bashkive në raport me ligjin e planifikimit urban. Shiko, po marr këtë ligjin e planifikimit urban, meqënëse këtë mbajta shënim, në asnjë moment nuk është se planifikimi i territorit ka qenë 100% kompetencë e bashkive. Gjithmonë ka pasur një legjislacion në nivel qendror, një ligj të urbanistikës që e miraton parlamenti, një rregullore të urbanistikës të përgjithshme që miratohet me vendim qeverie, dhe plane rregulluese që miratohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit, dhe pastaj vijnë kompetencat e bashkive për implementimin e këtij legjislacioni apo për vendimmarrje bazuar mbi këtë kuadër të përgjithshëm. Pra, asnjëherë nuk mund të thuash që ore planifikimi urban ka qenë 100% kompetencë e bashkive që bënte kryetari çfarë të deshte në territor. Gjithnjë ka qenë në balancë: kuadër ligjor qendror i përgjithshëm, ligj VKM, rregullore, dhe pastaj pjesa jonë. Tani, si mund të lëvizë kjo balanca? Të lëvizin ca gjëra nga kuadri i përgjithshëm dhe të shkojnë tek bashkitë apo t'ju merren disa bashkive? Këtu unë jam i mendimit që, në rast se ka lëvizje, duhet të jenë në sensin që t'ju rriten kompetencat bashkive në drejtim të planifikimit të territorit. E njëjta logjikë është gjithandej. Pra, nuk ka, mos mendoni asnjë kompetencë që delegohet dhe qeveria nuk ka asnjë lloj instrumenti që të ndikojë. Ka patjetër, parlamenti miraton ligjet, ju miratoni ligjet, qeveria miraton VKM-të, pastaj ministritë miratojnë udhëzimet, dhe kjo është gjithë pjesa e kuadrit. Akte ligjore dhe nënligjore, dhe pastaj vijnë bashkitë që i zbatojnë. Nuk ka ndonjë kompetencë që ne ta bëjmë ligjin siç duam vetë, të bëjmë dhe VKM-në, të nxjerrim dhe aktet nënligjore, edhe t'i zbatojmë edhe vetë. Por këtu tani balanca në disa nga këto kompetenca mund të lëvizë drejt bashkive duke na mbështetur financiarisht. Kjo është shumë e rëndësishme, dhe po e themi, nuk po themi: "Unë nuk jam i kënaqur me mbështetjen aktuale." Dhe jo vetëm në Shqipëri, po kam parë edhe në Bashkinë e Gjermanisë, edhe në Francë, asnjëherë, asnjëherë, domethënë, edhe njëherë, asnjë kryetar bashkie nuk thotë që jam i kënaqur me buxhetet që kam, edhe me burimet që kam. Të gjithë kërkojnë, është njerëzore. Je këtu? Sa më tepër.

## **Arbjan Mazniku:**

Zoti Filo, shumë faleminderit. Po bëj unë dy komente të shkurtra në mënyrë që ta mbyllim, meqënëse kemi kaluar oraret. Pika e parë që besoj se është e rëndësishme të thuhet, sepse përmendet në mënyrë të rregullt, dhe besoj se dhe nga fjalimi dhe i zotit Filos, po dhe i zotit Olçiu, po dhe i kryetarëve të tjerë, doli është që nënvlerësohet një fakt. Në vitin 2014, 2015 më pas, ka pasur një reformë të madhe decentralizuese, e cila ka sjellë një seri funksionesh të reja tek bashkitë, që bashkitë dhe komunat më pas më përpara nuk i kanë pasur. Mirëmbajtja e shkollave, marr vetëm si shembull, automatikisht kërkonte që shkollat të moren një urë pastruesish, rojet e shkollave, mirëmbajtësit e shkollave, ai që riparon derën, banjën, një xham kur thyhet, një bën një lysterje në fund të vitit. Pra, gjithë mirëmbajtjen standarde që gjithë këto stafe nuk kishin këto bashkia më përpara. Për më shumë, bashkitë dhe një pjesë e madhe e bashkive jam i sigurt që kanë ndodhur dhe në këtë bashki që kemi këtu, për ta rregulluar pastaj siç duhet këtë punë, madje shtuan një roje diku, një pastrues diku, një mirëmbajtës diku, për ta çuar në optimum mirëmbajtjen e

shkollave, e cila përpara nga komunat nuk bëhej as siç duhet. E njëjta gjë vlen me pastrimin e qyteteve. Kur ne do përmirësojmë pastrimin, nuk bëhet me një numër pastruesish, dhe një pjesë e madhe e ish-komunave nuk pastroheshin fare. Kanalet e Kullusë së Vadicës ishin një funksion se e kishim përpara. Nëse bashkitë do mirëmbajnë kanalin e Kullusë së Vadicës, do të thotë që do të kenë një person që jep ekskavatorit, një person që jep qafëgjatit, një person që bën mirëmbajtjen, kontrollin e kanaleve, bën plane punës për atë pastrim. Kopshtet dhe çerdhet nuk ishin funksion i bashkive deri në moment. Edukatorët, pastrueset, kuzhinierët e kopshteve janë stafe të reja që u shtuan. Zjarrfikësit nuk kishin staf detyre bashkive. U shtua si funksion i ri. Bashkë me këto shtohen zjarrfikësit. Shërbimi social nuk ishte funksion i bashkive dhe komunave. Një pjesë e madhe e bashkive këtu kanë qendra sociale që kanë punonjës socialë, që kanë njerëz që ofrojnë shërbime për moshën e tretë apo shërbime të tjera sociale. Secila prej këtyre elementëve ka shtuar stafet e bashkive në funksion të shërbimeve. Ama, angazhimi që është marrë dhe të dhënat e provojnë këtë gjë. Për sa i përket aparateve, aparatet janë stafet, për t'ia shpjeguar dhe qytetarëve që na ndjekin, janë stafet e bashkive që merren me planifikim, financa, zyra juridike, zyra e planifikimit urbanik, zyra e planifikimit ekonomik, pra ato që janë njerëzit që rrinë në zyra pak a shumë. Ato, në mënyrë sistematike, fjala që bie, bashkitë dhe komunat që u bashkuan në Bashkinë e Korçës, kishin 304 punonjës në aparat. Sot, Bashkia e Korçës ka 156 veta, 48.7% më pak në aparat. Padyshim ka më shumë njerëz se ka më shumë mirëmbajtje, më shumë pastrim, më shumë roje, më shumë njerëz që merren me kanalet e Kullusë së Vadicës në total staf. Po aparati është me ulje. Bashkia e Devollit e ka pasur aparatit 128, e ka 70. Bashkia e Pogradecit e ka pasur 478 aparatit, e ka 186. Bashkia Maliq e ka pasur aparatit 275. Jo vetëm bashkia, por njësitë përbërëse që u bashkuan me ligj e kanë sot 146. Bashkia Kolonj e ka pasur 126, e ka 38 aparatit. Që do të thotë, në tërësi, aparatet e bashkive janë ulur, dhe kjo është pra numri i njerëzve që merreshin me organizimin dhe funksionimin e institucionit. Janë ulur. Padyshim që numri, kur janë shtuar funksionet dhe është përmirësuar cilësia e shërbimit, do rritej dhe numri i shërbimeve. Nga ana tjetër, element tjetër kyç, i cili, dhe kjo është pika e fundit që do të bëj, teksa padyshim ne duhet të vendosim një theks të qëndrueshëm në elementët e fondit të investimeve, besoj që është detyra jonë të diskutojmë në mënyrë të qëndrueshme dhe për fondet operacionale, ku janë fondet mirëmbajtëse, sepse nuk mund të vijojmë më në Shqipëri që ne të bëjmë investime të reja dhe më pas mos i mirëmbajmë, dhe më pas na prishen, dhe më pas sa vite do t'i bëjmë nga fillimi. Dhe kur ne rrisim fondin e investimeve, në vitet pasardhëse duhet të rritim fondin operacional për mirëmbajtje, sepse në këtë mënyrë sigurojmë qëndrueshmëri afatgjatë të bashkive, dhe besoj që këto janë elementë që duhet t'i marrim parasysh në mënyrën se si ecim përpara. Ju falenderoj shumë për të gjithë kontributin tuaj gjatë ditës sotme të gjatë, dhe do mbetemi sërish në kontakt, plus që kemi dhe takimin në Korçë, ku besoj që do vijojmë diskutimet edhe me publikun. Faleminderit.

### **Luçiano Boçi:**

Po, ju falenderoj dhe unë. Megjithatë, s'dua të bëj polemikë, po e sqarova çështjen e parashikimit të funksioneve, kompetencave, financave, sepse në 2014-n nuk ka rëndësi u shtua kjo u shtua, do shtoheshin se ishin parashikuar aty, dhe u deklarua që do ulesh

numri i administratës, i të punësuarve, do kurseheshin 80 milion euro, dhe këto do ktheheshin në investime. Sot, nga 19 mijë në total që ishte me 373 njësitë vendore, është bërë 40 mijë. Po t'i shtosh edhe të punësuarit part-time, që ndodh gjithmonë para fushatave elektorale, shkon gati në 45 mijë. Pra, ajo ishte e parashikuar. Dakord, janë shtuar sipas funksioneve, se u shtuan funksionet nga reforma. Po jo, dyfishohesh në total. Dhe këtu abuzimi dihet është i madh. Shpesh ka akuza që dikush është jashtë, fut kartën, merr pagën, dikush rri te klubi përballë bashkisë, fut kartën, merr pagën, e tha zoti Mziu, nuk ka zyrë, kompjuter apo detyrë të përcaktuar qartazi. Po, kjo administrata ka pak rritje, sepse janë shtuar këto tjerët që janë ata pjesët e tamam e ujit, pjesa e qylit që vjen për shkak të përkatësisë politike. Dhe pjesa tjetër, këtu dua të përsënder zotin Duro, në fakt, që e kemi kërkuar dhe nga kryetarët e tjerë të bashkive që të bëjnë kërkesë, mos jetë granti i pakushtuar dhe i kushtëzuar 1% e PBB-së, e Produktit të Përgjithshëm Bruto. Jo, të jetë 4%, 5%, 14% e ka Gjermania. Hajde të gjejmë modelin për autonominë financiare. Nuk vjen autonomia thjesht me arsyetimin që sigurohen të ardhurat nga vetë bashkia. Jo. Autonomia vjen duke i dhënë lekë nga taksat, taksat e të gjithë njerëzve, bashkive, dhe duke i dhënë atyre autoritet t'i menaxhojnë vetë sipas nevojave dhe kërkesave, se përndryshe hajde ta mbyllim pushtetin. Nuk mund të mbyllet, se ka identitet të fortë. Por ama, hajde ta hapim Voskopojën, se ka identitet të fortë. Unë jam dakord që Voskopoja mund të ketë marrë investime, por ka një arsye shumë historike dhe shumë bazike dhe shumë patriotike, sepse jemi një komb që kemi dhe historinë tonë. Sikur Voskopoja të ishte një bashki, atë ndriçimin, reflektimin për kontributin që ka dhënë në historinë e Shqipërisë do ta kishte më të madh dhe do të ishte pjesë e një krenarie më të madhe. Në qoftë se ndër vite ne ja humbasim këtë identitet historik dhe kulturor, duke mos i dhënë këtë autoritet administrativ, kam frikë se do e harrojmë dhe në histori, në brezat që vijnë. Pra, ka disa rreziqe që nuk janë të matshme nga ana matematikore, por janë rreziqe. Edhe shpopullimi është rrezik, jo kaq matematikor. Ai territor i ri i pabanuar do banohet nga të ardhur, do vijnë njerëz, do e mbushin atë territor. Natyra e urren boshllëkun, ta dini. Do e plotësojnë njerëz të tjerë. Dhe do ndodhi ajo që ka ndodhur ndoshta me shtete të tjera ndër shekuj dhe vite, ai pushtimi i butë që në Shqipëri s'ka ndodhur në shekuj, por mund të ndodhi tani.